



RAPORT SHPJEGUES

i Presidentit të Republikës, Sh.T.Z. Ilir Meta

**për
Komisionin e Venecias.**

16 shtator 2019

Përmbajtja

I.	Përmbledhje ekzekutive.....	4
II.	Hyrje	8
III.	Caktimi i datës së zgjedhjeve – Dekreti nr.10928.	8
IV.	Kriza politike dhe nisja e protestave.....	8
V.	Pandëshkueshmëria e krimit zgjedhor - Dosjet penale 184, 339 dhe përshkallëzimi i krizës politike.....	9
VI.	Kriza kushtetuese – zbatimi i njëanshëm i reformës në drejtësi.....	11
VII.	Rekomandimet eksplicite të Komisionit të Venecias dhe shkelja e tyre:	12
	1. Prokurori i Përgjithshëm.....	12
	2. Gjykata Kushtetuese	13
VIII.	Kriza institucionale dhe e përfaqësimit - delegjitimimi i institucioneve.	14
IX.	Opozita nuk regjistrohet për konkurrim në zgjedhjet vendore të 30 qershor 2019	15
X.	Zgjedhjet vetëm me një kandidat çënojnë:	16
	1. Parimin e pluralizmit politik.....	16
	2. Detyrimet e Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.....	17
	3. Angazhimet që burojnë nga MSA	19
XI.	Përpyekjet e Presidentit të Republikës për vendosjen e dialogut të pazëvendësueshëm politik. ...	20
XII.	Rritja e pasigurisë dhe shqetësimit të aktorëve vendas dhe ndërkombëtarë.	23
XIII.	Përshkallëzimi i situatës rrezik për destabilizim.	24
XIV.	Presidenti i Republikës vendos anulimin e zgjedhjeve datë 30 qershor.	25
XV.	Reagimi i Kryeministrit dhe mazhorancës ndaj Dekretit nr. 11199	28
XVI.	Koordinimi politik Kuvend - KQZ pas miratimit të Dekretit nr.11199.....	29
XVII.	Njëanshmëria politike dhe paligjshmëria e KQZ.	33
XVIII.	Zhbalancimi politik i KQZ dhe veprimtaria antiligjore e njënashme dhe e pakontrolluar e këtij organi. 34	
XIX.	Procesi fiktiv i Kolegjit Zgjedhor i pavlefshëm në raport me Dekretin nr. 11199.	35
XX.	Historik i shtyrjes së zgjedhjeve nga Presidenti i Republikës në Shqipëri.	38
XXI.	Raste analoge të shtyrjes së datës së zgjedhjeve – Standardet më të rëndësishme se data.....	39
XXII.	Veprimtaria e Presidentit të Republikës për zgjidhjen e krizës pas datës 10 qershor 2019.....	40

XXIII. Caktimi i datës 13 tetor 2019 për zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.....	43
XXIV. KONKLUSIONE	49
XXV. Gjetjet kryesore të raportit përfundimtar të Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve (EOM) të ODIHR/OSBE për votimet të dt. 30.06.2019	52
XXVI. ANEKS.....	55

I. Përmbledhje ekzekutive

Anëtarësimi në BE është objektivi strategjik kombëtar ende i papërbushur i Shqipërisë.

Me synim çeljen sa më parë të negociatave të anëtarësimit që kërkonin përbushjen e prioriteteve kyçe, Presidenti i Republikës ka qenë i detyruar të ndërmarrë akte vendimtare për të garantuar besueshmërinë e zbatimit të reformave kyçe.

Shtyrja nga Këshilli Europian i vendimit për çeljen e negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë, nga qershori në mbledhjen e 17-18 tetorit, ofruan një dritare të re mundësie për një vendim pozitiv në favor të vendit.

Presidenti ka bërë përpjekje të qëndrueshme dhe maksimale që kredencialet demokratike të Shqipërisë të përmirësoheshin duke respektuar jo vetëm kushtetutën por edhe detyrimet në kuadër të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) Shqipëri-BE, standardeve të OSBE, si dhe në funksion të ushtrimit të Kryesisë së OSBE gjatë 2020, duke qenë një shembull pozitiv edhe për vendet e tjera në përbushjen e standardeve zgjedhore dhe demokratike.

Rreziku i cënimit të integritetit të procesit zgjedhor të 30 qershor 2019 që do të ndikonte negativisht mbi këtë vendim, u evidentua qartë edhe në raportin e OSBE/ODIHR, ku konstatohet se kjo periudhë u karakterizua nga antagonizmi i thellë i palëve dhe mungesa e përgjegjësisë së përbashkët.

Raporti përfundimtar i OSBE/ODIHR për procesin zgjedhor të 30 qershorit 2019 pohon qartë se :

“Kriza politike u intensifikua me afrimin e ditës së zgjedhjeve”¹.

“Ky antagonizëm ishte tregues i mungesës së përgjegjësisë së përbashkët ndaj integritetit të procesit zgjedhor që duhet të tejkalonte ndasitë partiake, dhe, rrjedhimisht, ndikoi negativisht në të drejtën e qytetarëve për të marrë pjesë në qeverisje”².

“Shumë interlokutorë të EOM përgjatë gjithë spektrit politik besonin se një marrëveshje ndërmjet partive është e nevojshme për të parandaluar humbjen e mëtejshme të besimit ndaj demokracisë, zgjedhjeve dhe politikanëve”³.

Proceset zgjedhore në Shqipëri gjithmonë janë karakterizuar nga mosbesimi ndërmjet palëve politike. Jo rrallë herë, mosbesimi është thelluar si pasojë e mungesës së dialogut politik duke përshkallëzuar në qëndrime antagoniste dhe ndeshje force mes palëve. Nuk kanë munguar as rastet fatkeqe kur konflikti politik ka çuar në polarizim të skajshëm shoqëror, deri në përplasje civile me pasoja shkatërrimtare për rendin demokratik dhe institucional, për sigurinë publike dhe për sigurinë e jetës së qytetarëve dhe pronës.

¹ Raporti përfundimtar i OSBE/ODIHR për procesin zgjedhor të 30 qershorit 2019

² Po aty

³ Po aty

Për shkak të këtij konteksti, proceset zgjedhore në Shqipëri janë mbikqyrur rregullisht me vëmendje të posaçme nga OSBE/ODIHR dhe organizma të tjerë ndërkombëtarë dhe kombëtarë që merren me monitorimin e zgjedhjeve.

Njëkohësisht, duke synuar mospërsëritjen e ngjarjeve që kanë njollosur historinë politike të demokracisë së brishtë shqiptare, janë ndërmarrë nisma të herëpashershme kushtetuese dhe ligjore. Këto nisma kanë patur si objekt vendosjen e një balance të drejtë në ndarjen dhe kontrollin e pushteteve, si dhe vendosjen e parimeve udhëheqëse që garantojnë një rend demokratik, në përputhje me parimet dhe standardet perëndimore.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon se Presidenti i Republikës është organi i vetëm kushtetues që ka kompetencën ekskluzive të caktojë datën e zhvillimit të zgjedhjeve të ligjshme dhe shtetërore.

Në zbatim të kësaj dispozite kushtetuese, Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 10928, datë 05.11.2018 caktoi datën 30 qershor 2019, si ditë e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore në Shqipëri. Palët i shprehën Presidentit të Republikës dakordësinë e tyre për zhvillimin e zgjedhjeve vendore datë 30 qershor 2019, edhe pse ndodheshin në kushtet e një klime të polarizuar politike, por gjithmonë brenda institucioneve.

Kufizimi i të drejtave të opozitës në Kuvend për të garantuar rolin e saj të ligjshëm por edhe të Kuvendit si mbikqyrës i qeverisë, në vecanti bllokimi apo paralizimi i disa komisioneve hetimore apo parlamentare dhe shmangja e llogaridhënies së detyrueshme nga përfaqësues të qeverisë në kuvend helmuan më tej klimën e mosbesimit tradicional midis palëve.

Ndërkohë afrimi i datës së zgjedhjeve përkoi me rrjedhjen në dy media ndërkombëtare të disa përgjimeve, pjesë e dy dosjeve penale të Prokurorisë.

Dosjet penale 184 dhe 339, kishin në përmbajtje të tyre të dhëna mbi krime zgjedhore që krijojnë dyshimin e arsyeshëm për lidhje të zyrtarëve të lartë të mazhorancës qeverisëse me banda famëkeqe kriminale, me qëllim manipulimin e rezultatit zgjedhor të zgjedhjeve lokale në Dibër 2016 dhe të zgjedhjeve parlamentare në Durrës 2017, në favor të Partisë Socialiste.

Mos-hetimi për një kohë të gjatë i këtyre dosjeve dhe fakti që personat e përfshirë në këto krime zgjedhore gëzonin edhe imunitet politik, nxitën opozitën të ndërmerre hapin ekstrem të dorëheqjes në bllok nga 182/58 mandatet parlamentare. Mazhoranca reagoi duke zëvendësuar pa vonesë dhe në kundërshtim me ligjin një pjesë të mandateve parlamentare me kandidatë të mbetur kryesisht në fund të listave shumëëmërore të opozitës.

182 deputetë dhe kandidatë për deputetë të opozitës dhanë dorëheqjen nga mandati parlamentar, duke sjellë si pasojë shterimin e listave shumëëmërore dhe mosplotësimin e Kuvendit me numrin e domosdoshëm kushtetues. Parlamenti ka mbetur me 122 deputetë nga 140 që parashikon Kushtetuta.

Kjo situatë do të komplikohet më tej për shkak të krizës së rëndë kushtetuese që po kalonte vendi, si pasojë e mosfunksionimit prej 18 muajsh të Gjykatës Kushtetuese dhe emërimit antikushtetues të kontestuar të Prokurorit të Përgjithshëm të Përkohshëm, më datën 18 dhjetor 2017.

Këto dhe të tjera, ishin pasojat e rënda që erdhën si rezultat i zbatimit të njëanshëm të Reformës në Drejtësi dhe në kundërshtim me rekomandimet e Komisionit të Venecias për ndryshimet kushtetuese të reformimit të sistemit të drejtësisë në Shqipëri.

Opozita vendosi të mosregjistrohej për zgjedhjet lokale të 30 qershorit, duke nisur një stinë protestash të rregullta kombëtare, që shënuan plagosje dhe lëndime të shumta dhe të përsëritura në rradhët e Policisë së Shtetit dhe të qytetarëve.

Ndërkohë Kryeministri organizonte paralelisht mitingje në qytete të ndryshme, në të njëjtën ditë dhe orë me opozitën, ku të dy palët shkëmbenin retorika konfrontuese dhe kërcënuese.

Përprjekjet disa mujore dhe intensive të Presidentit të Republikës, dhe thirrjet e aktorëve të tjerë vendas dhe të huaj për rivendosjen urgjent të dialogut politik ndërmjet palëve, qenë të pasuksesshme. Të dy palët politike u angazhuan për një ndeshje force që po përshkallëzonte drejt konfliktit civil pa marrë asnjë përgjegjësi për pasojat.

Antagonizmi politik në rritje mes palëve, gjuha e urrejtjes dhe e përçarjes nxitën përshkallëzimin dhe tensionin shoqëror, që mund të shoqërohej me pasoja të pakontrollueshme, duke rrezikuar sigurinë publike, stabilitetin demokratik, qetësinë dhe paqen sociale në vend.

Duke vlerësuar tërësinë e rrethanave dhe informacioneve kritike në dispozicion si Kreu i Shtetit, Presidenti i Republikës vendosi që të mos qëndrojë indiferent në kushtet kur kërcënoheshin si siguria publike ashtu edhe pluralizmi politik në vend. Presidenti anuloi zhvillimin e zgjedhjeve të 30 qershor 2019, gjë që ndikoi menjëherë në qetësimin e situatës.

Presidenti nisi konsultimet me palët për caktimin e një date të re të zgjedhjeve. Presidenti vendosi datën 13 tetor 2019 për zhvillimin e zgjedhjeve lokale në vend, duke siguruar periodicitetin kushtetues të zgjedhjeve, si dhe duke u dhënë mundësi palëve të tërhiqen nga qëndrimet helmuese antagoniste dhe të vendosin interesin kombëtar mbi atë partiak.

Dekreti i Presidentit për anulimin e datës së zgjedhjeve më 30 qershor u mbështet tërësisht në argumenta kushtetues dhe ligjorë, duke marrë gjithashtu parasysh domosdoshmërinë e respektimit të detyrimeve të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe angazhimeve që burojnë nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit Shqipëri-BE.

Sipas Kushtetutës, ky lloj dekreti është e drejtë ekskluzive e Presidentit të Republikës dhe nuk i nënshtrohet në aspektin kushtetues dhe ligjor as kontrollit dhe as kontestimit nga Kuvendi, si në rastet e dekreteve të tjera (si kthimi i ligjeve për rishqyrtim apo emërimi në disa institucione kushtetuese).

Po kështu, pretendimi se sipas Kushtetutës Presidenti nuk mund të shfuqizojë dekretet e nxjerra prej tij nuk qëndron, pasi sipas kësaj logjike, as Kuvendi dhe as Këshilli i Ministrave nuk mund të shfuqizojnë respektivisht as ligjet dhe as vendimet e nxjerra prej tyre.

Mazhoranca socialiste refuzoi zbatimin e dekretit të Presidentit të Republikës, dhe nëpërmjet një rezolute të Kuvendit dhe manovrave të paligjshme, në koordinim me Komisionin Qendror të

Zgjedhjeve të dominuar nga përfaqësues të PS, dhe ndjekjen e një procesi fiktiv në Kolegjin Zgjedhor, pretendoi rrëzimin e Dekretit të Presidentit duke vijuar me zhvillimin e votimeve një-partiake.

Dekreti i Presidentit të Republikës nr. 11199 datë 10.6.2019 që anullon zgjedhjet e 30 qershorit është në fuqi dhe i detyrueshëm për zbatim nga të gjithë.

Ai ka tërësisht natyrë kushtetuese dhe si i tillë mund të gjykohet vetëm nga Gjykata Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese është jo-funksionale prej 18 muajsh.

Raporti përfundimtar i OSBE/ODIHR për procesin zgjedhor të 30 qershorit 2019 në Republikën e Shqipërisë pasqyron hollësisht këto gjetje dhe të tjera të lidhura me këtë proces të paligjshëm dhe ilegjitim.

II. Hyrje

Kushtetuta është ligji më i lartë dhe themeltar në Republikën e Shqipërisë.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 92, shkronja “gj”, parashikon se:

“Presidenti cakton datën e zgjedhjeve për Kuvendin, për organet e pushtetit vendor dhe për zhvillimin e referendumeve”.

Presidenti i Republikës është organi i vetëm kushtetues që ka kompetencën ekskluzive të caktojë datën e zhvillimit të zgjedhjeve të çdo lloji, përfshirë referendumet.

Sipas Kushtetutës, vetëm data e zgjedhjeve e dekretuar nga Presidenti i Republikës mundëson zhvillimin e zgjedhjeve të ligjshme dhe shtetërore. Kjo është praktika e konsoliduar dhe e padiskutuar në historinë kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

Presidenti i Republikës është përcaktuar si autoriteti ekskluziv që ushtron kompetencën kushtetuese të caktimit të datës së zgjedhjeve për shkak të rolit dhe funksionit të tij si Kreu i Shtetit dhe përfaqësues i unitetit të popullit.

III. Caktimi i datës së zgjedhjeve – Dekreti nr.10928.

Në ushtrim të kompetencave të tij kushtetuese dhe brenda kriterëve të parashikuara nga nenet 8 dhe 10 të Kodit Zgjedhor, Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 10928, datë 05.11.2018 caktoi datën 30 qershor 2019, si ditë e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

IV. Kriza politike dhe nisja e protestave

Polarizimi i fortë politik ka mbizotëruar gjatë 2018-2019. Mungesa e dialogut politik ndërmjet mazhorancës dhe opozitës thelluan ndasitë dhe mosbesimin ndërmjet palëve.

Qëndrimet e kundërta u thelluan më tej kur opozita bojkotoi Parlamentin gjatë muajve shtator-dhjetor 2018, dhe paralajmëroi dorëzimin e mandateve parlamentare kur mazhoranca rrëzoi me votë në Kuvend nismën e saj për ndryshime kushtetuese për realizimin e procesit veting në klasën politike.

Më herët opozita pat ngritur shqetësimin për kufizimin dhe bllokimin e rolit të saj mbikqyrës në parlament, përfshirë të drejtën e ngritjes së komisioneve hetimore dhe thirrjes për raportim përpara Kuvendit të anëtarëve të kabinetit qeveritar.

Qeveria nga ana e saj pretendonte se i kishte ofruar opozitës kohë të mjaftueshme në foltoren e Kuvendit, por se opozita kërkonte ta shfrytëzonte parlamentin për të bllokuar reformat e qeverisë.

Opozita pat denoncuar gjithashtu keqpërdorimin e veprimtarisë ligjbërëse të mazhorancës socialiste në Kuvend, e cila miratoi përmes ligjeve të posaçme antikushtetuese kontrata korruptive koncesionare.

Këto dhe të tjera pretendime për veprimtari antikushtetuese të mazhorancës qeverisëse mbeteshin vetëm në formën e denoncimeve publike. Çështjet e depozituara pranë Gjykatës Kushtetuese lidhur me kushtetutshmërinë e akteve dhe veprimeve të qeverisë nuk mund të gjykoreshin për shkak të daljes jashtë funksioni të Gjykatës Kushtetuese.

Qeveria nga ana e saj akuzonte opozitën se po rreshtohej në mbrojtje të gjykatësve të korruptuar, dhe se kishte frikë nga reforma e thellë në gjyqësor.

Në fillim të muajit dhjetor 2018, i gjithë vendi u përfshi nga një valë protesash masive të studentëve të arsimit të lartë kundër qeverisë, duke e detyruar Kryeministrin që në fillim të muajit janar 2019 të rikompozojë thujtë të gjithë kabinetin qeveritar.

Protesta të tjera të bizneseve të vogla dhe të mesme, të fermerëve, mjekëve, artistëve etj, vijuan të përhapen në qytete të ndryshme të Shqipërisë, duke kulmuar me protestën e dhunshme mbi taksën e vendosur në “Rrugën e Kombit” shoqëruar me djegie dhe shkatërrim, dhe protestën e banorëve të “Unazës së Re⁴” në Tiranë.

Qeveria reagoi ndaj protestës së dhunshme në “Rrugën e Kombit”, duke u tërhequr dhe rishikuar pasojat financiare mbi banorët e zonës së Kukësit.

Qeveria u tërhoq pjesërisht nga projekti i “Unazës së re”, duke pranuar falsifikimin e dokumenteve të firmës zbatuese të projektit. Por mosngazhimi i organit të Prokurorisë dhe i strukturave të tjera ligjzbatuese në lidhje me hetimin e plotë të kësaj çështjeje korruptive krijuan hije të forta dyshimi për ndikim në vendimet dhe veprimtarinë e organit të Prokurorisë nga ana e qeverisë.

Kjo çështje që mori dhe mbulim të gjerë mediatik, thelloi edhe më shumë kundërshtitë ndërmjet kampeve politike dhe forcoi pretendimet e opozitës për kapjen nga ana e mazhorancës së organeve të drejtësisë.

V. Pandëshkueshmëria e krimit zgjedhor - Dosjet penale 184, 339 dhe përshkallëzimi i krizës politike.

Qëndrimet antagoniste dhe përplasjet politike u thelluan më tej me afrimin e datës së zgjedhjeve lokale⁵. Thirrjet e herëpashershme të Presidentit të Republikës për vendosjen urgjent të dialogut politik dhe përqendrimin në reformat kyçe që lidhen me vendimin për çeljen e negociatave të anëtarësimit me Bashkimin Evropian nuk gjetën reflektimin e asnjërës prej palëve.

⁴ Historiku i denoncimit të aferës korruptive për projektin infrastrukturor në “Unazën e Re” gjendet bashkëlidhur.

⁵ Raporti i OSBE/ODIHR konstaton se: “Antagonizmi ndërmjet partive politike ishte tregues i mungesës së përgjegjësisë ndaj integritetit të procesit zgjedhor”.

Ndërkohë që rekomandimet e OSBE/ODIHR mbetën të patrajuara për shkak të mungesës së dialogut politik konstruktiv ndërmjet mazhorancës dhe opozitës, në media rrodhën të dhëna nga dosje zyrtare në posedim të prokurorisë që dëshmonin mbi krime zgjedhore gjatë zgjedhjeve të pjesshme lokale në Bashkinë Dibër (2016) dhe zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare të vitit 2017⁶.

Siç pat evidentuar edhe OSBE/ODIHR në raportin e fundit për zgjedhjet e përgjithshme 2017, gjatë procesit zgjedhor ishin vërejtur me shqetësim fenomeni i shit-blerjes së votës, i presionit ndaj votuesve si dhe abuzimi i burimeve shtetërore për të ndikuar në rezultatin zgjedhor.

Tashmë provat për disa nga pretendimet e opozitës, të paqyruara edhe në raportin e OSBE/ODIHR, gjendeshin në dy dosje të administruara nga Prokuroria me numrat 184 dhe 339. Nga materialet e publikuara, të rrjedhura në mediat shqiptare dhe ndërkombëtare, dilte në pah një skemë e mirëorganizuar që lidhte zyrtarë të lartë të Partisë Socialiste, përfshirë Ministra të kabinetit qeveritar, Kryetarë Bashkish, Oficerë të Lartë të Policisë së Shtetit dhe nëpunës të tjerë të lartë civilë të cilët bashkëpunonin me banda famëkeqe kriminale (përfshirë në trafik ndërkombëtar droge) për manipulimin e rezultatit zgjedhor në favor të Partisë Socialiste.

Këto të dhëna, edhe pse në dispozicion të Prokurorisë prej më shumë se dy vitesh, nuk i kishin vënë në lëvizje Organet Hetimore për të kryer veprime të mëtejshme ligjore. Asnjë prej autorëve, përfshirë eksponentë të lartë të mazhorancës socialiste, nuk u dërguan përpara përgjegjësisë penale. Personat e përfshirë në këtë skemë kriminale gëzonin si imunitet politik ashtu edhe pandëshkueshmëri ligjore⁷.

Publikimi i këtyre skandaleve përforcoi pretendimet e opozitës dhe denoncimet e hershme të saj për bashkëpunimin mes mazhorancës socialiste me krimin e organizuar⁸, për të siguruar marrjen e pushtetit përmes manipulimit të votës.

Opozita pretendoi se Parlamenti aktual i dalë nga zgjedhjet e 2017 nuk përfaqësonte vullnetin e lirë të popullit shqiptar, duke shtuar se në kushtet e kapjes edhe të organeve të drejtësisë nga Kryeministri e mazhoranca e tij socialiste ajo nuk kishte rrugëdalje tjetër veç ndërmarrjes së hapit ekstrem të djegies së mandateve parlamentare.

Nga ana e saj, qeveria fillimisht mohonte ekzistencën e provave që implikonin zyrtarë të Partisë Socialiste në krime zgjedhore, dhe akuzonte opozitën se përpiqej të mbulonte dobësinë e saj politike me njollosje të imazhit të vendit dhe të zyrtarëve të lartë socialistë.

Kryeministri dhe zyrtarë të tjerë të lartë të PS paditën disa anëtarë të opozitës për shpifje. Kryeministri ngriti padi edhe ndaj gazetarit të të përditshmes gjermane “Bild”, e cila publikoi një pjesë të përgjimeve audio, pjesë e dosjeve të prokurorisë.

⁶ Bashkëlidhur informacion mbi publikimin në të përditshmen gjermane “Bild” të materialeve nga dosjet 184 & 339.

⁷ Raporti përfundimtar i OSBE/ODIHR konstaton se: “mungesa e efikasitetit të hetimeve penale kontribuon në perceptimin e pandëshkueshmërisë mbi krimet zgjedhore të kaluara, duke përfshirë blerjen e votës dhe presionin ndaj votuesve.”

⁸ Opozita arriti të kalojë në parlament ligjin për “Dekriminalizimin”, që pamundësonte mbajtjen e ofiqeve publike të personave me precedent penalë. Si pasojë e zbatimit të këtij ligji, një numër i lartë zyrtarësh, përfshirë deputetë, anëtarë të Partisë Socialiste u detyruan të largohen nga funksionet publike për shkak të precedentëve penalë në të kaluarën.

Ndërsa organi i prokurorisë reagoi ndaj këtyre skandaleve mediatike duke komunikuar publikisht se kishte nisur hetimet mbi “rrjedhjen e informacionit hetimor”, ndërkohë që nuk dha asnjë sqarim mbi fatin e të dhënave hetimore të dosjeve 184⁹ dhe 339 në dispozicion të saj.

Në këto kushte opozita nisi organizimin e rregullt të protestave masive kombëtare duke kërkuar dorëheqjen e kryeministrit dhe zhvillimin e zgjedhjeve të përgjithshme të parakohshme.

Atmosfera u helmua më tej me përdorimin e gjuhës armiqësore dhe përçarëse nga të dy kampet politike gjatë komunikimeve të tyre publike. Protestat u shoqëruan me akte dhune nga protestuesit si dhe me reagim shproporcional nga ana e Policisë së Shtetit.

Përpara, gjatë dhe pas protestave pati thirrje konstante nga Presidenti i Republikës dhe përfaqësues të trupit diplomatik në Tiranë për vetëpërmbajtje në ushtrimin e të drejtës për të protestuar, për dënimin e dhunës, si dhe për reagim proporcional nga ana e Policisë së Shtetit.

Protestat gjetën mbulim të gjerë mediatik kombëtar dhe ndërkombëtar, për shkak të intensifikimit të përplasjes që po shkonte drejt shpërthimit të një konflikti civil.

VI. Kriza kushtetuese – zbatimi i njëanshëm i reformës në drejtësi

Zbatimi i njëanshëm¹⁰ dhe në kundërshtim me rekomandimet e qarta të Komisionit të Venecias dhe parashikimet kushtetuese të reformës në sistemin e drejtësisë ishte një prej shkaqeve kryesore për lindjen dhe përshkallëzimin e krizës.

Zgjedhja e njëanshme e Prokurorit të Përgjithshëm të Përkohshëm (term që nuk ekziston në Kushtetutë), bllokimi i funksionimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED) dhe nxjerrja jashtë funksioni të Gjykatës Kushtetuese, mosfunksionimi i Gjykatës së Lartë, emërimet në kundërshtim me ligjin të disa drejtuesve të institucioneve të reja të drejtësisë, si dhe përdorimi i standardeve të dyfishta në procesin e vetingut, krijuan dyshimin e arsyeshëm për kapjen e sistemit të drejtësisë nga ana e mazhorancës dhe përdorimin e tij për qëllime politike.

Rekomandimet e Komisionit të Venecias ishin e vetmja bazë për arritjen e konsensusit politik historik për realizimin e reformës kushtetuese në drejtësi, për të garantuar një sistem drejtësie të pavarur dhe të pakapur nga politika.

⁹ Në përfundim të afatit 3-vjeçar të regjistrimit të procedimit penal (gusht 2016), dosja penale 184 që i përket krimeve zgjedhore të kryera në Qarkun Dibër, u transferua nga Prokuroria e Krimeve të Rënda për kompetencë lëndore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Dibër.

¹⁰ Bashkëlidhur historiku i zbatimit të njëanshëm të reformës në drejtësi dhe pasojat e krijuara.

VII. Rekomandimet eksplicite të Komisionit të Venecias dhe shkelja e tyre:

Për të shmangur rrezikun e kapjes politike të organeve të reja të drejtësisë Komisioni i Venecias rekomandoi që zbatimi i reformës, ashtu si edhe miratimi i saj në Kuvend, të ruante frymën e konsensusit.

1. Prokurori i Përgjithshëm

Duke i kushtuar vëmendje edhe më të posaçme shmangies së kapjes politike të Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Komisioni i Venecias rekomandoi që:

“Deri në zgjedhjet parlamentare të qershorit 2017, (deri në 1 shtator 2017¹¹) zgjedhja e Prokurorit të Përgjithshëm të bëhet me 2/3 e anëtarëve të Kuvendit (94 vota), ndërsa pas datës 1 shtator 2017 zgjedhjet e tjera të Prokurorit të Përgjithshëm të bëhen me 3/5 e anëtarëve të Kuvendit, (84 vota)”.

Përpara mbarimit të mandatit të ish-Prokurorit të Përgjithshëm, më 11 dhjetor 2017, Presidenti i Republikës u bëri thirrje forcave politike që sëbashku të zgjidhnin sipas rekomandimeve të Komisionit të Venecias dhe në frymën e Kushtetutës, Prokurorin e ri të Përgjithshëm¹².

Përkundër këtij rekomandimi eksplicit të Venecias dhe thirrjes së Presidentit të Republikës, në dhjetor 2017 mazhoranca socialiste zgjodhi në mënyrë të njëanshme Prokurorin e Përgjithshëm të Përkohshëm¹³ me 69 vota.

ONM

ONM u përfshi si një mekanizëm mbikqyrës ndërkombëtar që do të ofronte garanci për zbatimin objektiv dhe transparent të procesit të rivlerësimit kalimtar.

Përkundër këtij rekomandimi dhe dispozite të jashtëzakonshme kushtetuese, vendimi për vlerësimin e disa kandidatëve për organet e reja të drejtësisë është marrë në kundërshtim me gjetjet dhe rekomandimet e ONM, duke ngjallur dyshime të arsyeshme për përzgjedhje selektive të provave dhe fakteve përgjatë procesit veting. Një pjesë e anëtarëve të organeve qeverisëse të sistemit të drejtësisë (KLGJ dhe KLP) janë emëruar në këto detyra kyçe pavarësisht opinionit negativ të ONM.

Në lidhje me procesin e veting, Komisioni i Venecias do të tërhiqte vëmendjen se:

“...duhet të mbahet mend se një zgjidhje e tillë radikale nuk do të ishte e këshillueshme në kushte normale, pasi krijon tensione të mëdha brenda gjyqësorit, destabilizon punën e tij, shton mosbesimin e publikut në gjyqësor, largon vëmendjen e gjyqtarëve nga detyrat e tyre normale,

¹¹ Mazhoranca e atëhershme në Kuvend (PS + LSI) në momentin e miratimit të reformës zotëronte mbi 84 vota, pra mbi 3/5 e anëtarëve të Kuvendit të Shqipërisë.

¹² Prokurori i Përgjithshëm i Përkohshëm u zgjodh në 18 dhjetor 2017.

¹³ Prokurori i Përgjithshëm i Përkohshëm nuk ekziston si parashikim në Kushtetutë.

dhe, si çdo masë e jashtëzakonshme, krijon rrezikun e kapjes së gjyqësorit nga forca politike që kontrollojnë procesin”.

Pikërisht ky shqetësim i Komisionit të Venecias po verifikohet në vend. Këtë e evidenton edhe raporti i OSBE/ODHIR, i datës 5 shtator 2019 kur citon se: “Ndërsa gjyqtarët e Kolegjit Zgjedhor gëzojnë imunitet dhe nuk mund të jenë subjekt i procedurave disiplinore gjatë gjithë afatit për të cilin Kolegji është i konstituuar, ata i nënshtrohen procesit të vettingut në vazhdim, i cili mund të ndikojë në sigurinë e mandatit të tyre dhe në këtë mënyrë të ndikojë në pavarësinë e tyre.”

2. Gjykata Kushtetuese

Gjykata Kushtetuese gjatë 26 viteve ka gëzuar vlerësimin më të lartë ndër të gjithë institucionet e sistemit të drejtësisë në Republikën e Shqipërisë.

Presidenti i Komisionit të Venecias, z. Gianni Buquicchio, me rastin e 20-vjetorit të krijimit të Gjykatës Kushtetuese do të pohonte se: “Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë ka ndihmuar për garantimin e stabilitetit kushtetues dhe vazhdon të japë kontributin e saj për zhvillimin e demokracisë në vend.”

Nxjerrja e qëllimtë jashtë funksioni e Gjykatës Kushtetuese u bë përmes dy mekanizmave paralele. Ndërkohë që procesi vetting zbraste Gjykatën Kushtetuese, mazhoranca Socialiste bllokoi funksionimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED) për të mos lejuar plotësimin e vendeve vakante¹⁴.

Nëse KED nuk do të ishte bllokuar përgjatë 2017-2018, Gjykata Kushtetuese do të kishte vijuar funksionimin normal, pasi vakancat e krijuara do të ishin plotësuar rast pas rasti.

Presidenti i Republikës ka qenë i vetmi që ka bërë çdo përpjekje institucionale për funksionimin e KED. Fatkeqësisht përpjekjet e tij të pandërprera u minuan nga mazhoranca socialiste me qëllim bllokimin e KED, duke sjellë si pasojë daljen jashtë funksioni të Gjykatës Kushtetuese.

Mungesa e Gjykatës Kushtetuese funksionale dhe zgjedhja e njëanshme antikushtetuese e Prokurorit të Përgjithshëm të Përkohshëm nxorren tërësisht jashtë kontrollit dhe hetimit penal vendimarrjet e qeverisë dhe të Kuvendit.

Aktualisht në Gjykatën Kushtetuese janë të regjistruara rreth 100 çështje të pashqyrtuara.

Nxjerrja jashtë funksioni e Gjykatës Kushtetuese prej 18 muajsh ishte një nga faktorët kryesorë që ndikuan në përshkallëzimin drejt kësaj krize të paprecedentë kushtetuese, institucionale dhe të përfaqësimit.

Çdo zë publik, përfshirë Presidentin e Republikës, që kërkonte rikthimin në shinat e kushtetutshmërisë dhe të rekomandimeve të Komisionit të Venecias të zbatimit të reformës në drejtësi, anatemohej nga mazhoranca socialiste si “armik i reformës në drejtësi” apo si “shënjestër e drejtësisë së re të reformuar.”

¹⁴ Shiko historiku i zbatimit të njëanshëm të reformës në drejtësi dhe pasojat e krijuara.

VIII. Kriza institucionale dhe e përfaqësimit - delegjtimimi i institucioneve.

Mosbesimi i tejskajshëm dhe qëndresa në llogoret politike diametralisht të kundërta përkeqësuan më tej klimën politike. Mungesa e plotë e dialogut politik dhe kokëfortësia e palëve për të vazhduar kursin e përplasjes ndikuan në polarizimin e mëtejshëm të shoqërisë.

Nën presionin e shtuar të mbështetësve të tyre dhe të zërave publikë me peshë në opinionin vendas, partitë opozitare deklaruan dorëzimin në bllok të dorëheqjes nga mandatet parlamentare në Kuvendin e Shqipërisë. Ky akt ekstrem i paprecedentë në historinë politike të demokracisë shqiptare i dha një përmasë të re krizës në vend, tashmë jo vetëm politike, kushtetuese dhe institucionale por edhe të përfaqësimit.

Thirrjet publike të Presidentit të Republikës drejtuar të dy palëve për prapësim nga ky kurs përplasjeje, dhe çdo përpjekje tjetër për të vendosur urgjent një kanal dialogimi mes palëve qenë të pasuksesshme.

Opozita dorëzoi në bllok mandatet parlamentare (**182** mandate të dorëzuara/refuzuara), ndërsa mazhoranca përshpejtoi procedurat e dorëheqjeve dhe zëvendësimin e tyre¹⁵, në shkelje të Kushtetutës, Kodit Zgjedhor dhe rregullores së Kuvendit¹⁶.

Formalisht, opozita aktuale parlamentare përfaqëson Partitë opozitare që kanë braktisur Parlamentin. Por në realitet, në Shqipëri, zgjedhësit votojnë sipas preferencave për Partitë politike dhe kryetarët e tyre. Shumica e kandidatëve që kanë pranuar mandatet parlamentare në emër të opozitës, janë të panjohur për zgjedhësit, pasi kryesisht ata renditeshin në pikën fundore të listave të hartuara nga Kryetarët e Partive.

Delegjtimimi i institucioneve vijoi me braktisjen nga ana e opozitës të përfaqësimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) si dhe në Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor (KZAZ).

¹⁵ Në total, kanë refuzuar ushtrimin/marrjen e mandatit **182 deputetë dhe kandidatë për deputet**.

Kanë refuzuar marrjen e mandatit **124 kandidatë** për deputet nga lista shumëemërore të opozitës.

Kanë dhënë dorëheqje në bllok nga mandatet **58 deputetë**.

Numri **aktual** i deputetëve në Kuvendin e Shqipërisë është **122**, ndërkohë që **Kushtetuta përcakton se numri i deputetëve në Kuvendin e Shqipërisë duhet të jetë 140**.

18 mandate të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë kanë mbetur **të paplotësuara** për shkak të shterimit të listave shumëemërore të kandidatëve për deputet të Partisë Demokratike.

¹⁶ Bashkëlidhur argumentat ligjore të paligjshmërisë së procesit të dorëheqjes dhe zëvendësimit të mandateve nga Kuvendi dhe KQZ.

IX. Opozita nuk regjistrohet për konkurrim në zgjedhjet vendore të 30 qershor 2019

Në përfundim të afatit ligjor të regjistrimit të kandidatëve dhe partive politike për pjesëmarrje në zgjedhjet e 30 qershorit, partitë politike të opozitës nuk u regjistruan për të konkurruar si subjekte zgjedhore në KQZ dhe as në KZAZ përkatëse.

Opozita argumentoi se shkak për mospjesëmarrjen në zgjedhjet vendore është mungesa e kushteve për zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme sipas standardeve demokratike.

Dorëheqja e Kryeministrit, vënia përpara drejtësisë së autorëve të krimeve zgjedhore të dosjeve penale 184 dhe 339, dhe zhvillimi i zgjedhjeve të përgjithshme të parakohshme ishin tri kushtet e panegociueshme për opozitën.

Kryeministri nëpërmjet statuseve në rrjetet sociale i ofronte drejtuesit të Opozitës dialog, me kushtin e panegociueshëm që 30 qershori të mos ishte çështje për diskutim në tryezën e bisedimeve.

Këto qëndrime antagonistike e bënë krejtësisht të pamundur dialogun ndërmjet palëve, pavarësisht përpjekjeve të përsëritura të Presidentit të Republikës për të mundësuar uljen në tryezën e bisedimeve.

Këtë situatë kritike e ka përshkruar edhe Misioni i Vëzhguesve të Zgjedhjeve të OSBE/ODIHR, në Raportin e Ndërmjetëm dhe përfundimtar 2019¹⁷,

“Më 21 shkurt, të gjithë anëtarët e parlamentit nga partitë opozitare kryesore, Partia Demokratike (PD) dhe Lëvizja Socialiste për Integritet (LSI), përveç dy deputetëve nga PD dhe një nga LSI, dorëzuan mandatet e deputetit pas votimit nga parlamenti kundër iniciativës së tyre për vetting-un e politikanëve. Prej atëherë, kanë vazhduar protestat sistematike të partive opozitare, të udhëhequra nga PD-ja, ku janë shënuar incidente dhune. Opozita ka kërkuar dorëheqjen e Kryeministrit dhe krijimin e një qeverie tranzitore që do ta përgatiste vendin për zgjedhje të parakohshme parlamentare.

Kryeministri i ka hedhur poshtë publikisht këto kërkesa. Përmes disa letrave publike të postuara në mediat sociale në fund të muajit maj, Kryeministri e ka ftuar Kryetarin e PD-së, Lulzim Basha, për dialog, duke konfirmuar në të njëjtën kohë se zgjedhjet do të zhvillohen më 30 qershor dhe duke kundërshtuar krijimin e një precedenti të ndryshimit të datës së zgjedhjeve. Reagimi i PD-së ka mbetur i pandryshuar dhe ajo vazhdon të përsërisë kërkesat e saj.

Presidenti Meta ka ofruar në mënyrë të përsëritur të lehtësojë dialogun mes palëve dhe në fund të muajit maj shprehu vullnetin për shtyrjen e zgjedhjeve”.

Kjo krizë edhe sot vijon të shoqërohet me mungesën e mekanizmave kushtetuese që mund t’u jepnin përgjigje kërtimeve të mundshme kushtetuese.

¹⁷ Citon faqen 2-3 të raportit të OSBE/ODIHR, bashkëlidhur.

Konkretisht, Shqipëria vijon të jetë në një krizë të rëndë kushtetuese për shkak se prej 18 muajsh Gjykata Kushtetuese nuk është funksionale.

Së fundmi, edhe Gjykata e Lartë ka dalë tërësisht jashtë funksionit për shkak të mungesës së kuorumit minimal me 3 anëtarë, ndërkohë që prej më shumë se një viti funksiononte me një trupë shumë të cunguar të anëtarëve të saj.

Kjo gjendje ka rrezikuar seriozisht rendin kushtetues dhe stabilitetin demokratik të Shqipërisë, për faktin se mekanizmat kushtetuese që mbajnë nën kontroll dhe garantojnë ndarjen dhe balancimin midis pushteteve nuk funksionojnë.

Në kushtet kur secila palë politike demonstroi mungesë të aftësisë dhe vullnetit për t'u rikthyer në kufijtë e kushtetueshmërisë së veprimtarisë së saj do të duhej që Gjykata Kushtetuese të ruante të pacenuara parimet e ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe pavarësisë së institucioneve, apo të garantonte qeverisjen e vendit brenda shirave kushtetuese.

Mungesa e Gjykatës Kushtetuese është jo vetëm një nga shkaqet thelbësore të kësaj krize kritike, por edhe vështirëson më tej zgjidhjen e saj.

Sikundër paralajmëroi Komisioni i Venecias, zbatimi i njëanshëm i Reformës në Drejtësi do të sillte kapjen e institucioneve të reja të drejtësisë nga maxhoranca në pushtet.

Tashmë është e qartë që Kryeministri, përmes kontrollit, ndikimit dhe presionit sistematik publik në procesin e vetingut dhe bllokimit të KED-së prej vitit 2017, synon kapjen e Gjykatës Kushtetuese me qëllim përdorimin e saj politik, për të legjitimuar veprimtarinë antikushtetuese të maxhorancës dhe kufizuar të drejtat kushtetuese të institucioneve të pavarura, por edhe të qytetarëve¹⁸.

X. Zgjedhjet vetëm me një kandidat çenojnë:

1. Parimin e pluralizmit politik.

Realizimi i zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore pa pjesëmarrjen e opozitës është problematike në aspektin demokratik, sepse u pamundëson qytetarëve shqiptarë të zgjedhin midis alternativave konkurruese përfaqësuesit e tyre në nivel vendor.

Raporti përfundimtar i OSBE/ODIHR në gjetjet e tij vëren se: “Zgjedhjet lokale të 30 qershorit u mbajtën me pak konsideratë për interesat e elektoratit. Votuesit nuk kishin mundësi zgjedhjeje thelbësore midis opsioneve/alternativave politike”¹⁹.

Në këtë mënyrë, qytetarëve shqiptarë praktikisht u hiqet mundësia e zgjedhjes mes alternativave dhe në thelb e drejta kushtetuese për të zgjedhur nuk mund të aplikohet, pra kufizohet.

¹⁸ Për më tepër shiko në Aneks 1 / 2/ 3 /4 & 5.

¹⁹ Raporti përfundimtar i OSBE/ODIHR.

Në zgjedhjet e fundit për Kuvendin e Shqipërisë në qershor të vitit 2017 partitë aktuale politike opozitare (PD, LSI, PDIU dhe partitë e tjera) kanë siguruar 48.14 % të totalit të votave, ndërkohë që Partia Socialiste me aleatët e saj politikë, ka siguruar në total rreth 49.83 % votave.

Ndërkohë që në zgjedhjet e fundit për organet e qeverisjes vendore të zhvilluara në Shqipëri në qershor të viti 2015, këto forca politike që përbëjnë sot bllokun opozitar, kanë siguruar 48,6 % të votave, ndërkohë që Partia Socialiste me aleatët e saj aktuale ka siguruar në total rreth 43 % votave.

Referuar këtyre të dhënave, zhvillimi i zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore në 30 qershor 2019, pa pjesëmarrjen e opozitës, e cila përfaqëson së paku gjysmën e elektoratit shqiptar, çënon disa parime kushtetuese që gëzojnë mbrojtje të posaçme kushtetuese.

Kushtetuta parashikon qartë se e drejta themelore për të zgjedhur dhe respektimi i parimit të pluralizmit politik janë bazat e funksionimit të shtetit tonë, dhe secili ka për detyrë t'i respektojë dhe t'i mbrojë ato.

2. Detyrimet e Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut

Zhvillimi i zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, pa garë, pa pjesëmarrjen e opozitës, dhe në një situatë të tensionuar politike me rrezik përshkallëzimin drejt një konflikti social do të përbënte, veç të tjerash, një shkelje flagrante të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe pikërisht të Nenit 3 të Protokollit nr.1 të saj.

Në këtë dispozitë të Konventës, parashikohet se:

“Palët e larta kontraktuese marrin përsipër të organizojnë në intervale të arsyeshme kohore, zgjedhje të lira me votim të fshehtë, në kushte që të sigurojnë shprehjen e lirë të mendimit të popullit...”

KEDNJ është ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, botuar në Fletoren Zyrtare nr.20, datë 12 gusht 1996 dhe ka hyrë në fuqi më datë 27 gusht 1996.

Referuar neneve 5 dhe 116 të Kushtetutës, KEDNJ bën pjesë në aktet e detyrueshme për zbatim në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Përsa i takon hierarkisë së akteve të zbatueshme ajo renditet menjëherë pas Kushtetutës.

Ndërsa në fushën e respektimit dhe mbrojtjes të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, ajo qëndron në të njëjtin nivel me Kushtetutën.

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut është institucioni i vetëm që gëzon autoritetin ekskluziv të interpretimit të neneve Konventës dhe protokolleve të saj, si dhe të shqyrtojë në rrugë përfundimtare kërkesat e individëve për shkelje të të drejtave të parashikuara nga Konventa.

Një prej të drejtave dhe lirive themelore që parashikohen nga konventa është edhe e drejta mendimit të lirë, që aplikohet edhe nëpërmjet ushtrimit të drejtës së votës në mënyrë të fshehtë, të lirë dhe të pandikuar.

GJEDNJ, në vitin 2015 ka shqyrtuar çështjen *Riza & Others vs. Bullgaria*, no. 318 (2015) e cila në thelb ka trajtuar këtë dispozitë të konventës që lidhet pikërisht me të drejtën e votës.

Në këtë çështje 101 shtetas bullgarë me origjinë turke që jetonin në Turqi në vitin 2009 kanë pretenduar shkeljen e të drejtës së votës së tyre dhe për këtë ata iu drejtuan Gjykatës, e cila në vitin 2015, u shpreh me vendim duke arsyetuar se:

“E drejta e votës e garantuar nga neni 3 i Protokollit nr. 1 nuk është e kufizuar në veprimin e zgjedhjes së një kandidati dhe hedhjen e votës në kutinë e votimit.

Vota e çdo zgjedhësi duhet të krijojë mundësinë (e këtij të fundit) të ndikojë në formimin e organeve ligjvënëse në të kundërt e drejta e votës, procesi i zgjedhjeve dhe për rrjedhojë edhe rendi demokratik në përgjithësi do t’i mungonte e drejta në substancën e saj”.

Për rrjedhojë, gjykata vendosi se situata e krijuar ishte në shkelje të së drejtës së votës të mbrojtur nga neni 3 i Protokollit nr. 1 të Konventës së të Drejtave të Njeriut, duke vendosur edhe dëmshpërblimin financiar të kërkuar për një shumë të caktuar.

Sipas këtij intepretimi që ka bërë GJEDNJ për nenin 3, të Protokollit nr. 1 të KEDNJ, dhe standardeve që Gjykata ka vendosur në lidhje me parashikimet e Konventës mbi të drejtën e votës së lirë është logjike dhe e pashmangshme që nëse në Shqipëri do të realizohen votime, pa garë, pa konkurrencë, pa pjesëmarrjen e opozitës, në një situatë të tensionuar politike dhe me rrezik potencial të përshkallëzimit të një konflikti social, atëherë kjo situatë në vendin tonë do të përbënte shkelje të hapur të parashikimeve të Konventës, e rrjedhimisht cënim të së drejtës së votës. Kjo gjendje, krijon mundësi që Shqipëria përveç se do të listohej ndër vendet shkelëse të Konventës në këtë drejtim, por do të kishim edhe ndëshkim financiar të shtetit shkelës (Shqipërisë), përkundrajt çdo individ që do të pretendonte apo ngrinte një kërkim të tillë pranë Gjykatës Europiane.

Pikërisht për të shmangur këtë mundësi dhe për të mos e renditur Shqipërinë në listën e vendeve që mohon të drejtën e shtetasve për të zgjedhur në një rend demokratik, Presidenti i Republikës, me vendimmarrjen e tij për anulimin e datës 30 qershor dhe tashmë me caktimin e datës 13 tetor 2019 si ditë e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, veç të tjerave kontribuon në respektimin e parashikimeve të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Një tjetër aspekt që Presidenti i Republikës vlerëson se meriton vëmendje, e konstatuar edhe nga OSBE-ODIHR në raportin e datës 14 qershor 2019 është fakti se, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, nuk përmban asnjë rregullim specifik për zgjedhje pa kundërshtarë”.

Ky vakum ligjor në Kodin Zgjedhor, duhet të përbëjë një kusht detyrues për forcat politike për plotësimin e tij përgjatë procesit të realizimit gjithëpërfshirës të reformës së plotë zgjedhore.

Në këto kushte, derisa ky vakum ligjor të plotësohet në zbatim të nenit 5, 116, 122 të Kushtetutës, është e detyrueshme që për trajtimin e kësaj çështjeje organet kompetente, përfshirë Presidentin e Republikës, t'u referohen dhe zbatojnë drejtpërdrejt Kushtetutën dhe Konventën Europiane për të Drejtave të Njeriut.

Në këtë mënyrë, Presidenti i Republikës, me anulimin e datës 30 qershor dhe caktimin e datës 13 tetor 2019, si ditë e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore është në mbështetje dhe në respekt të plotë të të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë dhe në Nenin 3 të Protokollit 1 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe standarteve më të larta të vendosura nga GJEDNJ-ja.

3. Angazhimet që burojnë nga MSA

Shqipëria është vend kandidat i Bashkimit Evropian.

Një prej detyrimeve themelore të Republikës së Shqipërisë në procesin e integritimit evropian është zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit “Shqipëri-BE”, hyrë në fuqi më 1 prill 2009.

Në preambulën e MSA përcaktohet se:

DUKE MARË PARASYSH angazhimin e Palëve për të kontribuar me të gjitha mënyrat për stabilizimin politik, ekonomik e institucional të Shqipërisë dhe rajonit, nëpërmjet zhvillimit të shoqërisë civile dhe demokratizimit, ndërtimit të institucioneve dhe reformës së administratës publike, integritimit në tregtinë rajonale dhe rritjes së bashkëpunimit ekonomik, si dhe nëpërmjet bashkëpunimit në një gamë të gjerë fushash, veçanërisht në drejtësi dhe çështjet e brendshme dhe në forcimin e sigurisë kombëtare dhe rajonale;

DUKE MARË PARASYSH angazhimin e Palëve për rritjen e lirive politike e ekonomike që janë bazat themelore të kësaj marrëveshjeje, si dhe angazhimin e tyre për të respektuar të drejtat e njeriut dhe shtetin e së drejtës, përfshirë të drejtat e personave që u përkasin minoriteteve kombëtare, si dhe parimet demokratike nëpërmjet një sistemi shumëpartiak me zgjedhje të lira e të ndershme;

Por përkundrejt këtyre angazhimeve për të kontribuar me të gjitha mënyrat për stabilizimin politik, ekonomik e institucional të Shqipërisë dhe rajonit dhe për zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme të cilat janë komponent kyç i kritereve të Kopenhagës, rezulton se në Shqipëri, në kushtet aktuale, për mungesë përgjegjësie të të dy palëve, u zhvilluan votime një partiake dhe pa garë²⁰.

²⁰ Raporti përfundimtar i OSBE/ODIHR vëren se: “...Votuesit nuk kishin mundësi zgjedhjeje thelbësore midis opsioneve/alternativave politike...Antagonizmi ndërmjet partive politike ishte tregues i mungesës së përgjegjësisë ndaj integritetit

Në rast se Shqipëria zhvillon zgjedhje, në një situatë të pastabilizuar politike, pa pjesëmarrjen e opozitës dhe ku në pjesën dërrmuese konkurron për organet drejtuese vetëm një forcë politike, atëherë kjo situatë përbën shkelje të drejtpërdrejtë të detyrimeve të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit dhe parimeve bazë të saj, çka do të përbente një regres me pasoja të rënda për të ardhmen Europiane të vendit.

Në këtë mënyrë objektivi kombëtar i shqiptarëve do të dëmtohej në atë masë sa që rikuperimi do të kërkonte një kohë shumë të gjatë.

XI. Përpjekjet e Presidentit të Republikës për vendosjen e dialogut të pazëvendësueshëm politik.

Presidenti i Republikës që prej marrjes së detyrës ka bërë çdo përpjekje që vendi të mos arrinte në këtë fazë kritike.

Presidenti i Republikës në të gjitha qëndrimet publike²¹ ka ftuar në mënyrë të përsëritur palët që përmes dialogut konstruktiv të bashkëpunojnë me fokus reformat kyçe që lidhen me çeljen e negociatave të anëtarësimit me Bashkimin Europian.

Raporti i ndërmjetëm (14 qershor 2019) i OSBE/ODIHR për procesin zgjedhor të 30 qershorit 2019 evidenton qartë se:

“ Presidenti Meta ka ofruar në mënyrë të përsëritur të lehtësojë dialogun mes palëve dhe në fund të muajit maj shprehu vullnetin për shtyrjen e zgjedhjeve”.²²

Duke i paraprirë zgjedhjeve vendore të 30 qershorit, Presidenti i Republikës u kërkoi palëve politike që me përgjegjësi të bashkëpunojnë për realizimin në kohë të reformës zgjedhore, sipas rekomandimeve të OSBE/ODIHR. Presidenti theksoi se përmes kësaj reforme duhet të rikthehet besimi i qytetarëve tek zgjedhjet e lira dhe të ndershme, duke i shërbyer interesit më të mirë të vendit dhe duke përmbushur një nga kriteret kyç të Kopenhagës.

Duke ndjekur hap pas hapi përshkallëzimin e situatës, kur opozita paralajmëroi dorëheqjen nga mandatet parlamentare, Presidenti i Republikës deklaroi nga Berlioni, në Intervistë me Deutsche Welle, më 19 shkurt 2019: *“..asnjë veprim ekstrem nuk i shërben demokracisë, nuk i shërben forcimit të institucioneve dhe nuk i shërben as integritetit europian të vendit, që është dëshira e çdo qytetari shqiptar²³.”*

Presidenti i Republikës u kërkoi forcave politike: *“.. të kemi një hap prapa nga opozita, por edhe dy hapa pas nga mazhoranca, nga qeveria dhe nga Kryeministri, të cilët duhet të kuptojnë që përgjegjësitë kryesore për qeverisjen e vendit janë të tyre. Është detyra e tyre të japin shembullin*

të procesit zgjedhor.... Atmosfera e pasigurisë ligjore dhe përplasja ndërmjet institucioneve kryesore minoi besimin e publikut për legjitimitetin e zgjedhjeve.”

²¹ Bashkëlidhur të gjitha qëndrimet e Presidentit të Republikës për vendosjen e dialogut politik.

²² Raporti i ndërmjetëm (14 qershor 2019) i OSBE/ODIHR për procesin zgjedhor të 30 qershorit 2019

²³ Presidenti i Republikës i bëri këto deklarata nga Gjermania, ku ndodhej për një vizitë pune.

të parët në respektimin e Kushtetutës dhe të kufijve që Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë i ka përcaktuar qeverisë.”

Në një tjetër qëndrim publik, Presidenti i Republikës evidentoi se: *“Ajo që mund t’i them.., zotit Rama si Kryetar i shumicës në Parlament, zotit Basha si Kryetar i opozitës, por edhe gjithë qytetarëve shqiptarë socialistë, demokratë apo pa parti, të cilët kanë shqetësim stabilitetin e vendit dhe duan siguri; duan çeljen e negociatave, duan ecje përpara drejt anëtarësimit në BE është se Presidenti i ka paralajmëruar aktorët vendas dhe ndërkombëtarë prej kohësh, që situata mund të shkojë drejt zhvillimeve të paparashikuara.*

Është e rëndësishme të shmangim çdo përshkallëzim të krizës, e cila mund të sjellë përplasje, të cilat i kemi parë në të kaluarën dhe që kanë çënuar rëndë interesin e vendit, kanë çënuar dhe jetën, të drejtat dhe pronën e qytetarëve dhe kanë vonuar proceset integruese të Shqipërisë.

Për këtë qëllim, unë i ftoj të gjithë të mos sakrifikojnë vendin për karriget e tyre apo për ambiciet personale.

Në këtë drejtim, edhe pse nuk kam asnjë përgjegjësi për këtë situatë që është krijuar edhe pse kam bërë çdo përpjekje prej gati dy vitesh në këtë detyrë, për të parandaluar një situatë dhe një krizë të tillë, përsëri jam i gatshëm të sakrifikoj i pari në emër të një zgjidhjeje politike që rivendos normalitetin kushtetues, institucional, politik, demokratik në vend dhe që garanton ecjen e shpejtë drejt çeljes së negociatave në BE.

Jam i gatshëm për dorëzimin e mandatit tim si President pasi të sigurohem që vendi ka një zgjidhje politike parimore, kushtetuese, solide e që çon përpara....jam i përgatitur dhe i gatshëm sepse asnjëherë, pavarësisht ambicjeve, nuk kam rrezikuar dhe nuk mund të pranoj të rrezikoj për karrige apo për ambicje, as Shqipërinë dhe as demokracinë në Shqipëri.

Unë do t’i qëndroj betimit tim që, midis pushtetit dhe demokracisë, do të mbaj gjithmonë krahun e demokracisë, sepse vetëm demokracia garanton një pushtet për popullin shqiptar në mënyrë që të ndalojmë shpopullimin e Shqipërisë” .

Në datë 7 prill 2019, në vijim të përpjekjeve të tij për dialog dhe zgjidhjen e krizës, Presidenti i Republikës ka dhënë këtë mesazh:

“Unë besoj vetëm tek dialogu dhe vetëm tek zgjidhja politike përmes një dialogu të përgjegjshëm dhe real për të rivendosur normalitetin e plotë kushtetues, institucional dhe demokratik të vendit. Besoj se pas vitit 1997 vendi ka bërë përparime të rëndësishme dhe i nxis e i inkurajoj të gjithë politikanët e përgjegjshëm kudo ku ata ndodhen, në mazhorancë apo në opozitë, të tregojnë që në këto 22 vite Shqipëria jo vetëm ka bërë përparime, por që edhe këto 22 vite nuk mund të shkojnë dëm për hir të kokëfortësive dhe të demonstrimeve të forcës përmes mitingjeve, dhe antimitingjeve të panevojshme. Aq më tepër që jemi edhe në prag të sezonit turistik, që dihet se është tejet i rëndësishëm për Shqipërinë dhe për ekonominë tonë. Kështu që unë besoj se ka një hapësirë të gjerë për të gjetur zgjidhjet e duhura dhe që secili të reflektojë. Besoj se është detyrë e tyre që të tregojnë vullnet real për dialog dhe të heqin dorë nga përdorimi i forcës si dhe të udhëhiqen vetëm nga arsyeja dhe interesi i përbashkët” .

Në të njëjtën frymë dhe me të njëjtin angazhim, Presidenti i Republikës, ka përcjellë mesazhet e tij publikisht, nëpërmjet prononcimeve publike dhe intervistave edhe në datat 17, 30 prill, dhe 17 maj 2019.

Situata politike në Shqipëri është ndjekur me vëmendje edhe nga faktori politik ndërkombëtar. Në datë 23 maj 2019, Unioni Kristiandemokrat dhe Kristiansocial (CDU/CSU) bënë një deklaratë zyrtare drejtuar palëve politike në Shqipëri. Në këtë deklaratë citohet:

"Po e vëzhgojmë me shqetësim të madh krizën e brendshme në Shqipëri. Për të ardhmen europiane të Shqipërisë nevojitet dialogu mes qeverisë dhe opozitës. Për këtë, të dyja palët duhet të afrohen me njëra-tjetrën dhe të jenë të gatshme për kompromise.

Protestat e përsëritura në Shqipëri janë një shenjë e pakënaqësisë së shumë qytetarëve. Ne bëjmë thirrje që protesta të jetë paqësore. Aktet e dhunës i dënojmë thellësisht. Është përgjegjësia e vendimarrësve të politikës që të sillen të arsyeshëm në këtë situatë dhe që me të gjitha forcat të përpiqen për ta qetësuar gjendjen. Nëse kjo nuk do të ndodhë, ekziston rreziku që vendit t'i mbyllet rruga drejt Europës.

Ne jemi edhe më tej të gatshëm që të kontribuojmë për hapjen e një dialogu ndërmjet qeverisë dhe opozitës për të kapërcyer krizën. Por kjo mund të funksionojë vetëm nëse të dyja palët hyjnë në bisedime pa vendosur parakushte. Gjithashtu nuk duhet të përjashtohet asnjë temë.

Zgjedhjet pa pjesëmarrjen e opozitës janë problematike në aspektin demokratik. Prandaj duhen vënë në tryezë të gjitha opsionet që u garantojnë qytetarëve mundësi të vërteta për të zgjedhur në zgjedhjet lokale. Këtu hyjnë edhe masa të jashtëzakonshme, si për shembull, shtyrja e datës së zgjedhjeve lokale. Qëllimi më i lartë duhet të jetë kthimi pa ekuivok në procedurat demokratike dhe respektimi i standardeve të shtetit të së drejtës në zgjedhje.

Bashkësisë ndërkombëtare nuk i interesojnë konfliktet politike ndërpartiake, por stabiliteti demokratik”.

Duke vlerësuar maksimalisht angazhimin e Bundestagut gjerman, të një vendi partner strategjik të Shqipërisë, por edhe aktor kyç në vendimmarrjen për çeljen e negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë me BE, Presidenti i Republikës në datë 24 maj 2019 u bëri një tjetër thirrje forcave politike në vend. Presidenti përsëriti thirrjen për prapësim nga rruga e konfliktit. Presidenti theksoi se ai ka përgjegjësi kushtetuese, që brenda caqeve që lejon Kushtetuta, të sigurojë respektimin, në formë e në përmbajtje të Kushtetutës, ku bashkëjetesa demokratike dhe uniteti i popullit janë parime kushtetuese që duhen mbrojtur, përpara çdo rregullimi tjetër dytësor apo formal.

Në fund, Presidenti i Republikës u bëri me dije palëve gatishmërinë për të rishikuar Dekretin për caktimin e datës së zgjedhjeve vendore dhe dekretimin e një date tjetër për zhvillimin e tyre, në përputhje me vullnetin e shprehur të palëve politike, siç do ishte rruga më e mirë nga pikëpamja politike.

XII. Rritja e pasigurisë dhe shqetësimit të aktorëve vendas dhe ndërkombëtarë²⁴.

Thellimi me kokëfortësi i ndasive mes palëve i dha përmasa të paprecedenta kësaj krize të panjohur më parë në historinë e demokracisë shqiptare. Kjo gjendje rriti pasigurinë, ndikoi negativisht në ekonominë kombëtare dhe nxiti emigracionin, kryesisht drejt vendeve europiane.

E gjithë vëmendja mediatike në vend u përqëndrua mbi të papriturat që po prodhonte ky testim force mes palëve, çka detyroi edhe drejtuesit e komuniteteve fetare që për herë të parë të përfshiheshin në një përpjekje të koordinuar për çtensionimin e situatës.

Përmes lutjeve publike për “uljen e gjakrave...ndalimin e gjuhës së ashpër...shmangien e vetëvrasjes së kombit..dhe...humnerës vdekjeprurëse” krerët e komuniteteve fetare bënë thirrje që “shoqëria të mos lejojë politikën të jetë shkak përçarjeje për popullin shqiptar”. Duke kërkuar vendosjen e një“dialogu të vërtetë” ndërmjet palëve, krerët e të gjitha besimeve theksonin se “sa më shumë të zgjasë kjo situatë, edhe më të rënda do të jenë pasojat për shoqërinë shqiptare.”

Komunitetet e Biznesit vendas dhe të huaj shprehën përmes deklaratave publike shqetësimin për rritjen e pasigurisë dhe pasojat që kjo sjell për investitorët ekzistues dhe të tjerë që parashikojnë të vendosen në Shqipëri.

Këshilli i Ambasadorëve në Shqipëri iu drejtua me një letër të hapur Kancelares Gjermane Angela Merkel dhe Presidentit Francez Emmanuel Macron për të ndërmjetësuar në zgjidhjen e krizës.

Shqetësime serioze shfaqën vendet fqinje Itali, Greqi, apo të tjera si Gjermania, Franca, Holanda dhe Mbretëria e Bashkuar, të cilat i druheshin një eksodi masiv nga Shqipëria, apo rrezikut për destabilizim të rajonit.

Zyrtarë të lartë të Bashkimit Evropian dhe vendeve anëtare paralajmëruan se kjo rrugë pa krye do të pengonte përparimin e Shqipërisë në BE.

Mediat vendase dhe ndërkombëtare raportnin për gjendjen kaotike që po mbërthente Shqipërinë, duke paralajmëruar përshkallëzimin drejt një konflikti të mundshëm civil.

Nuk munguan as deklarime publike nga ana e drejtuesve të lartë të PS që pretendonin për ndërhyrjen e faktorëve të tretë të huaj me qëllim destabilizimin e vendit.

Përpara dhe pas çdo proteste, trupi diplomatik i akredituar në Tiranë kanë bërë thirrje, deklarata dhe thirrje të forta kundër dhunës, qëndrimeve antagoniste mes palëve, me ftesën për bashkëpunim në interes të vendit dhe qytetarëve shqiptarë.

²⁴ Bashkëlidhur Anex ...

XIII. Përshkallëzimi i situatës rrezik për destabilizim.

Palët politike nuk reflektojnë asnjëherë, jo vetëm ndaj thirrjeve të Presidentit të Republikës, por ndaj çdo zëri të përgjegjshëm dhe objektiv kombëtar dhe ndërkombëtar. Sa më shumë afrohej data 30 qershor 2019, aq më tepër rritej trysnia e përplasjeve midis tyre.

Gjuha e urrejtjes dhe e përçarjes nxitën përshkallëzimin jo vetëm të antagonizmit politik por edhe tensionin shoqëror, që mund të shoqërohej me pasoja të pakontrollueshme, duke rrezikuar sigurinë publike, stabilitetin demokratik, qetësinë dhe paqen sociale në vend.

Palët politike u vunë në garë për ushtrim force me mjetet që kishin në dispozicion. Përgjatë protestave masive të zhvilluara nga opozita u konstatuan shpesh herë elementë të përdorimit të dhunës, ashtu sikundër forcat e rendit në shumë raste reagues në mënyrë joproporcionale me pasoja shëndetësore edhe për pjesën tjetër të popullsisë që nuk ishte pjesëmarrëse në protesta.

Gjatë dhe pas protestave të deriatëhershme të opozitës pati 31 policë të plagosur; 54 protestues të plagosur; 150 protestues të arrestuar dhe 8 policë nën hetim nga prokuroria. Gjatë protestave pati përdorim masiv dhe të pakontrolluar të gazit, me pasoja për shëndetin e qytetarëve, banorë të zonave përreth perimetrit të protestës.

Përgjatë çdo proteste pati plagosje dhe lëndime fizike nga të dy krahët, si nga ana e protestuesve ashtu dhe nga ana e forcave të rendit, të cilët iu nënshtruan menjëherë trajtimit mjekësor apo ndërhyrjeve kirurgjikale për shkak të lëndimeve të marra përgjatë protestave të zhvilluara.

Në protestën e datës 2 qershor 2019 opozita paralajmëroi zhvillimin e një proteste tjetër masive në Tiranë në datë 8 qershor 2019, ora 19.00.

Gjatë kësaj kohe dhe në vijim, Presidenti i Republikës u vu në dijeni se më datë 8 qershor mund të provokohej një konflikt destabilizues me pasoja për jetën dhe shëndetin e qytetarëve, sigurinë publike dhe rendin kushtetues në vend. Në bazë të informacioneve tepër kritike të institucioneve të sigurisë kombëtare dhe nga burime të tjera të besueshme profesionale të siguruar në cilësinë e Kreut të Shtetit, Presidenti u vu në dijeni se rreziku i provokimit të një konflikti civil me pasojë destabilitetin e vendit do të përforcohej me afrimin e datës së zgjedhjeve më 30 qershor, e shpallur si datë e demonstrimit të forcës ndërmjet dy palëve.

Presidenti mori informacion të besueshëm zyrtar nga institucione shumë të rëndësishme të sigurisë kombëtare se protesta e datës 8 qershor do të shfrytëzohej për djegjen e Parlamentit dhe me qëllime destabilizuese.

Shqetësimi për përshkallëzim të dhunshëm u rrit edhe në rradhët e faktorit ndërkombëtar, ku nuk munguan deklaratatë forta si në drejtim të drejtuesve të opozitës dhe qeverisë, ashtu edhe ndaj protestuesve për të dekurajuar pjesëmarrjen masive në protestën e 8 qershorit. Si pasojë e kësaj klime tejet të tensionuar protesta e 8 qershorit kapi edhe vëmendjen e mediave prestigjioze ndërkombëtare, të cilët stacionuan një numër shumë të madh gazetarësh në Tiranë.

XIV. Presidenti i Republikës vendos anulimin e zgjedhjeve të datës 30 qershor.

Pas rivlerësimit të thelluar të rrethanave dhe informacioneve të akumuluar që paralajmëronin provokimin e një konflikti destabilizues, domosdoshmërinë e çtensionimit urgjent të situatës, cënimin e pluralizmit politik në vend, bllokimin e procesit të integritimit evropian të Shqipërisë dhe me përgjegjësi të plotë kushtetuese, në datë 8 qershor 2018, Presidenti i Republikës vendosi të shfuqizojë Dekretin nr.10928, datë 05.11.2018 “Për zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore më datë 30 qershor 2019”, duke anuluar datën 30 qershor 2019, si ditë e zhvillimit të zgjedhjeve.

Ky vendim i Presidentit të Republikës u bë publik përpara nisjes së protestës së opozitës:

“1. Me shqetësimin e thellë për situatën kritike të krijuar në vend si pasojë e mos-reflektimit të asnjërës palë;

2. Duke patur parasysh domosdoshmërinë e çtensionimit urgjent të situatës dhe të rrezikut të përshkallëzimit të paparashikueshëm të konfliktit në vend;

3. Duke marrë përgjegjësinë e lartë kushtetuese e institucionale, dhe i bindur se mbrojtja e parimeve kushtetuese është më e rëndësishme se çdo afat ligjor, si Kreu i Shtetit dhe duke iu përmbajtur betimit për t’i shërbyer ruajtjes me çdo kusht të stabilitetit, paqes sociale dhe unitetit kombëtar;

4. Me vetëdije të plotë se kushtet aktuale nuk mundësojnë zhvillimin e zgjedhjeve të vërteta, demokratike, përfaqësuese dhe gjithëpërfshirëse. Zgjedhjet e lira dhe të ndershme janë kriter kryesor i Kopenhagës dhe në kushtet aktuale, për mungesë përgjegjësie të të dy palëve, po shkojmë drejt votimeve një partiake. Në këtë mënyrë minohet çdo mundësi për çeljen e negociatave të anëtarësimit me Bashkimin Evropian, dëmtohet imazhi si vend anëtar i NATO-s dhe cenohet kryesimi i OSBE-në për vitin 2020;

5. Duke ftuar të gjithë aktorët e përgjegjshëm vendas dhe ndërkombëtarë të bashkojnë kontributet konstruktive për rivendosjen urgjent të dialogut të pazëvendësueshëm politik dhe për gjetjen e një zgjidhjeje të shpejtë dhe që i shërben të ardhmes evropiane të Shqipërisë;

Kam vendosur të shfuqizoj Dekretin nr.10928, datë 05.11.2018 për zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore më datë 30 qershor 2019.

Në komunikimin e parë ditën e hënë, datë 10 qershor, në mëngjes, Institucioni i Presidentit të Republikës do të bëjë publikisht me dije të gjithë argumentat shteruese kushtetues, ligjorë dhe logjike që çuan në marrjen e këtij vendimi.

U bëj thirrje udhëheqësve të opozitës që protesta e sotme të zhvillohet në mënyrë tërësisht paqësore, larg çdo akti dhune.

Njëkohësisht u tërheq vëmendjen të gjitha palëve që të shmangin çdo provokim që mund të shfaqet gjatë protestës.”

Në datën 9 qershor, duke komentuar vendimin e Presidentit të Republikës, Zëvendëskryetari i grupit parlamentar gjerman CDU/CSU, Johann Vadepful, deklaroi në emër të grupit: "Pas vendimit të Presidentit, ekziston një situatë e re politike dhe të gjitha palët tani duhet të kërkojnë rrugën e pajtimit, duke përfshirë zgjedhjet lokale demokratike me kandidatë potencialë të

shumëfishtë, që do të thotë se të gjithë pranojnë vendimin e presidentit dhe pastaj marrin pjesë në procesin politik. Gjithçka tjetër do të jetë jo europiane dhe do të shtonte dyshimet në mënyrë të panevojshme sa i përket dobishmërisë së procesit të aderimit, duke krijuar kështu një bazë të re për bashkëjetesën paqësore të konkurrentëve politikë.

Në Europë, çdo qeveri duhet të pranojë një opozitë kritike, dhe çdo opozitë duhet të pranojë një qeveri efektive. Kjo është bazë esenciale për një shtet po aq të qëndrueshëm dhe demokratik. Nëse Shqipëria dëshiron të shkojë në këtë rrugë drejt Europës, sigurisht që do të marrë mbështetje nga Gjermania. "

Ditën e hënë, datë 10.06.2019, ora 08:00, Presidenti i Republikës nënshkroi publikisht përpara mediave Dekretin, ndjekur nga një konferencë e jashtëzakonshme për shtyp për dhënien e argumenteve shterues të këtij vendimi.

Presidenti i Republikës me Dekretin nr.11199²⁵, datë 10.06.2019, vendosi:

“Shfuqizimin e Dekretit nr.10928, datë 05.11.2018 “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore” duke anuluar datën 30 qershor 2019, si ditë e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” .

Në argumentimin ligjor, Presidenti i Republikës iu referua drejtpërdrejtë dispozitave kushtetuese, të cilat parashikojnë jo vetëm të drejtën ekskluzive të Presidentit të Republikës për të caktuar datën e zgjedhjeve (neni 92/gj) dhe për të nxjerrë dekrete (neni 93), por dhe dispozitave të nenit 1/3, 3, 4/2, 15, 45 të Kushtetutës, që parashikojnë parimet themelore kushtetuese të Republikës së Shqipërisë që mbrohen drejtpërdrejtë nga akti themeltar më i lartë i shtetit (Kushtetuta).

Pra, sipas parashikimeve të mësipërme dhe në kushtet e një situatë të jashtëzakonshme, vendimmarrja e Presidentit të Republikës për anulimin e datës së zgjedhjeve është mbështetur dhe është arsyetuar vetëm në dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pasi asnjë parashikim tjetër ligjor nuk mundësonte kapërcimin e situatës së krijuar.

Kushtetuta në nenin 4, pika 3 parashikon se, dispozitat e Kushtetutës zbatohen drejtpërsëdrejti, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe.

Për më tepër, referuar parashikimeve kushtetuese, në situatën e krijuar, diktuar nga rrethanat e saj, dhe në dobi të interesit të përgjithshëm²⁶, këtë vendim mund ta merrte vetëm Presidenti i Republikës, si në cilësinë e Kreut të Shtetit dhe përfaqësues i Unitetit të Popullit, ashtu dhe si organi që ka kompetencën ekskluzive për caktimin e datës së zgjedhjeve sipas nenit 92/gj të Kushtetutës.

Ky vendim i argumentuar i Presidentit të Republikës u pasqyrua edhe në Raportin e Ndërmjetëm të OSBE/ODIHR të datës 14 qershor 2019, ku citohet se: *“Më 10 qershor, duke iu referuar përgjegjësisë së tij kushtetuese për të mbrojtur pluralizmin dhe shqetësimeve për sigurinë publike, ai dekretoi shfuqizimin e dekretit për vendosjen e datës së zgjedhjeve”*.

²⁵ Bashkëlidhur Dekreti nr. 11199 dhe arsyetimi bashkëlidhur këtij akti.

²⁶ Bernard Maligner, « Qu'est-ce qu'un faible écart de voix dans la jurisprudence récente du Conseil constitutionnel et du Conseil d'Etat ? » in Mélanges en l'honneur de J.-C. Masclet, Publication de la Sorbonne, 2013, p. 298 et « Le Conseil constitutionnel, juge des opérations et des finances électorales », Nouveaux Cahiers du Conseil constitutionnel n° 41, oct. 2013, p. 47

Kjo gjetje e OSBE/ODIHR u reflektua edhe në raportin e datës 1 korrik dhe në raportin përfundimtar të datës 5 shtator 2019.

Vlen të theksohet se Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë nuk ka asnjë parashikim ligjor mbi mënyrën se si mund të zgjidhet apo trajtohet çështja kur në zgjedhje merr pjesë kryesisht vetëm një forcë e qëndrueshme politike (sic konstatoi edhe raporti i OSBE-ODIHR).

Ky konstatim evidentohet dhe në Raportin e Ndërmjetëm të datës 14 qershor 2019 të Misionit i Vëzhguese të Zgjedhjeve Vendore të 30 qershorit i OSBE/ODIHR, ku citohet ndër të tjera se:

“Në 31 bashki, kandidatët e PS-së për kryetarë bashkie garojnë pa kundërshtarë..... Nuk ekzistojnë dispozita specifike për zhvillimin e zgjedhjeve pa kundërshtarë”.

Dekreti nr.11199, datë 10.06.2019 dhe arsyet kushtetuese mbi të cilat u mbështet Presidenti i Republikës, iu dërguan menjëherë për zbatim brenda së njëjtës ditë në 10 qershor 2019, Komisionit Qendor të Zgjedhjeve dhe për botim Qendrës së Botimeve Zyrtare. Dekreti i Presidentit u botua në Fletoren Zyrtare nr. 84 ditën e martë, më 11 qershor 2019.

Nëpërmjet kësaj vendimmarrjeje, Presidenti i Republikës shuajti të gjitha marrëdhëniet juridiko-shoqërore të krijuara nga Dekreti i mëparshëm nr.10928, datë 05.11.2018, duke krijuar kështu një mundësi të re, një hapësirë kohe brenda së cilës palët politike në vend duhet të reflektonin për dialog, për një zgjidhje në funksion të interesave të vendit, larg interesave të ngushta e afatshkurtra partiake dhe që do të ndihmonte axhendën e përbashkët europiane të Shqipërisë.

Menjëherë pas nxjerrjes së Dekretit nr. 11199, Presidenti i Republikës nisi dialogun me të gjitha forcat politike që shprehën vullnet për të takuar Kreun e Shtetit.

Që prej deklaratës publike të Presidentit të Republikës të datës 8 qershor 2019, u vu re një situatë më e qetë në protestat e partive opozitare.

Kjo tregoi se shfuqizimi i Dekretit nr. 11199 shmangu një rrezik potencial për shpërthimin e akteve të dhunshme që do të kërcënonin rendin kushtetues, sigurinë publike, jetën, shëndetin, pronën publike dhe private.

Presidenti i Republikës, nëpërmjet vendimit datë 08.06.2019 dhe Dekretit nr.11199, shërbeu para së gjithash për ruajtjen e unitetit të popullit, rendit kushtetues, paqes sociale në vend, funksione dhe attribute të cilat Kushtetuta e Shqipërisë ia atribuon më së pari rolit të Kreut të Shtetit.

Misioni OSBE-ODIHR e vlerëson shumë qartë kontekstin e situatës antagonistike në vend, papërgjegjshmërinë e të dy palëve dhe kërcënimin e integritetit të zgjedhjeve, si dhe rëndësinë e arritjes së një marrëveshjeje midis palëve.

“Ky antagonizëm ishte tregues i mungesës së përgjegjësisë së përbashkët ndaj integritetit të procesit zgjedhor që duhet të tejkalonte ndasitë partiake, dhe, rrjedhimisht, ndikoi negativisht në të drejtën e qytetarëve për të marrë pjesë në qeverisje”²⁷.

“Shumë interlokutorë të EOM përgjatë gjithë spektrit politik besonin se një marrëveshje ndërmjet partive është e nevojshme për të parandaluar humbjen e mëtejshme të besimit ndaj demokracisë, zgjedhjeve dhe politikanëve”²⁸.

Pra në këtë situatë Presidenti i Republikës krijoi një mundësi të re për marrëveshje midis palëve për të reflektuar dhe caktuar një datë të re, ssa më të shpejtë, për zgjedhje gjithëpërfshirëse vendore.

XV. Reagimi i Kryeministrit dhe mazhorancës ndaj Dekretit nr. 11199

Pas bërjes publike të vendimit dhe më pas Dekretit nr. 11199 të Presidentit të Republikës, mazhoranca qeverisëse reagoi ashpër kundër veprimtarisë dhe vendimmarrjes së Kreut të Shtetit, duke pamundësuar edhe më shumë mbajtjen e një tryeze dialogu, apo mundësinë e Kreut të Shtetit për ndërmjetësimin e negociatave ndërmjet palëve.

Në mbyllje të protestës së opozitës datë 8 qershor, Kryeministri Edi Rama bëri të ditur se data e zgjedhjeve - 30 qershori - nuk ndryshon.

Kryeministri Rama, sëbashku me drejtues dhe figura kryesore të Partisë Socialiste (Kryetari i Grupit Parlamentar, Deputetë, Ministra, etj), sulmuan me fyerje dhe akuza publike Kreun e Shtetit, duke dëshmuar se qëndrimi ndaj dekretit të Presidentit ishte tërësisht politik dhe jo kushtetues.

Kushtetuta nuk parashikon kontrollin parlamentar të Dekretit nr.11199. Por në mungesë të Gjykatës Kushtetuese e cila do të mund të shqyrtonte çdo pretendim të mundshëm të mazhorancës, kjo e fundit, zgjodhi të anatemonte politikisht veprimtarinë e Kreut të Shtetit, duke e shoqëruar në mënyrë të vazhdueshme me kërcënime për shkarkim nga detyra, por pa mundur të cënonte fuqinë detyruese të dekretit të Presidentit të Republikës.

Kjo sjellje e mazhorancës mbi të gjitha dëshmoi mungesë vullneti për dialog dhe gatishmëri për zgjidhjen e krizës, duke e shndërruar çështjen në një konflikt politik dhe institucional me Presidentin e Republikës.

²⁷ Raporti përfundimtar i OSBE-ODIHR

²⁸ Raporti përfundimtar i OSBE-ODIHR

XVI. Koordinimi politik Kuvend - KQZ pas miratimit të Dekretit nr.11199

Presidenti i Republikës, në vijimësi ka konstatuar një veprimtari të koordinuar midis veprimeve të Partisë Socialiste dhe 4 anëtarëve të KQZ (përfaqësues të PS).

Pasi Presidenti i Republikës bëri publike arsyet e vendimmarrjes së tij, datë 10.06.2019, Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste paraqiti në Kuvend një kërkesë administruar me nr.2415 prot, datë 10.06.2019, për realizimin e një seance parlamentare me debat “Mbi dekretin e Presidentit të Republikës, për shfuqizimin e dekretit nr. 10 928, datë 05.11.2018 “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore” me qëllim miratimin e një rezolute.

Ndërkohë, KQZ në datë 10.06.2019, ora 14.00, zhvilloi një mbledhje e transmetuar drejtpërdrejt në media, në të cilën diskutoi mbi vijueshmërinë e procesit zgjedhor të datës 30 qershor 2019.

KQZ në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin Zgjedhor, gjithë kuadrin ligjor në fuqi, dhe në cenim flagrant të rendit kushtetues, në mungesë të plotë kompetencës, diskutoi në një mbledhje publikisht se nuk e njihje dhe nuk do ta zbatonte dekretin e Presidentit të Republikës, të datës 10 qershor 2019.

Sipas mbledhjes së KQZ transmetuar drejtpërdrejt në media, vetëm Kryetari i KQZ z. Klement Zguri, në këtë mbledhje kërkoi zbatimin e Dekretit të Presidentit pa e vendosur në diskutim atë. Ndër të tjera, ai deklaroi se, “Unë s’jam Gjykatë Kushtetuese të vlerësoj dekretin e Presidentit”. Pas kësaj deklarate, Kryetari i KQZ, u largua nga mbledhja dhe drejtimin e saj e mori nënkryetari z. Denar Biba. Në vijim 4 anëtarët e KQZ përfaqësues të Partisë Socialiste, e konsideruan Dekretin e Presidentit nr.11199, datë 10.06.2019, një akt që nuk duhet marrë në konsideratë.

Pa u shprehur me vendim, 4 anëtarët e KQZ, vijuan mbledhjen duke ndërmarrë vendime të ndryshme administrative. Referuar kuadrin kushtetues dhe ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë, KQZ nuk është organi kompetent për të shqyrtuar vlefshmërinë e Dekretit të Presidentit të Republikës dhe kësaj nuk mundet të arsyetojë mbi vlefshmërinë e këtij akti, ndërkohë që sipas Kodi Zgjedhor, KQZ është organ që vetëm duhet ta zbatojë atë (dekretin).

Ndërkohë Kuvendi në datë 13 qershor 2019, prej orës 10:00 deri në orën 16:30, zhvilloi një seancë parlamentare me debat. Në përfundim Kuvendi i Shqipërisë në orën 16:08, ka votuar Rezolutë “Mbi Aktin e Presidentit të Republikës për shfuqizimin e Dekretit nr. 10 928, Datë 5.11.2018 “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”. Në faqen 2-3, të kësaj rezolute evidentohet kjo përmbajtje:

“Kuvendi i Shqipërisë vlerëson se akti i Presidentit datë 10.6.2019 për shfuqizimin e dekretit nr. 10 928, datë 5.11.2018, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”, është një akt absolutisht i pavlefshëm, i nxjerrë në kapërcim të kompetencave kushtetuese dhe ligjore të institucionit të Presidentit dhe si i tillë ai konsiderohet nul dhe sikur nuk ka ekzistuar asnjëherë.

Kuvendi i Shqipërisë mbështet qëndrimin e KQZ për vijimin e procesit zgjedhor dhe inkurajon këtë organ të vijojë të mbrojë pacenueshmërinë, si dhe të garantojë vazhdimësinë e procesit zgjedhor për zgjedhjet vendore të datës 30 qershor 2019, në zbatim të dekretit të Presidentit nr.

10 928, datë 5.11.2018 “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”, duke e njohur këtë të fundit si të vetmin akt të ligjshëm të nxjerrë nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë në kuadër të zgjedhjeve vendore 2019.

Kuvendi i Shqipërisë u bën thirrje të gjitha organeve publike, që ngarkohen nga ligji me detyra, në kuadër të mbarëvajtjes dhe organizimit të zgjedhjeve vendore të qershorit 2019, të konsiderojnë si inekzistent aktin e Presidentit, datë 10.6.2019, për shfuqizimin e dekretit nr. 10928, datë 5.11.2018, dhe të vijojnë përmbushjen e detyrave të tyre sipas përcaktimeve në legjislacionin përkatës për të garantuar të drejtën kushtetuese të shtetasve shqiptarë për të zgjedhur përfaqësuesit e tyre në pushtetin vendor”.

Në seancën plenare të datës 13 qershor 2019, ku u votua kjo rezolutë, Kuvendi nuk diskutoi aspak mbi argumentat kushtetues, ligjorë dhe logjikë, mbi të cilat u mbështet Presidenti i Republikës në vendimmarrjen e tij. Për më tepër përgjatë gjithë kësaj seance nuk u reflektua aspak për zgjidhjen e krizës ku ndodhej vendi, por në gjithë diskutimet e mbajtura u vu një retorikë që nuk i shërben aspak, as zgjidhjes së krizës, dhe as paqes sociale në vend. Përgjatë kësaj seance nuk u kursyen fyerjet ndaj Institucionit të Presidentit të Republikës.

Me thirrjen për moszbatimin e dekretit, Kuvendi, në vend që të ndikonte për shuarjen e tensionit social midis mbështetësve të dy kampeve politike, riaktivizoi sërish gjuhën e urrejtjes dhe të përplasjes midis tyre. Kuvendi i Shqipërisë nëpërmjet rezolutës së miratuar më datë 13 qershor 2019, përveçse ofroi mbështetje pa asnjë vendim ndaj veprimtarisë së paligjshme të KQZ, riaktivizoi sulmet politike ndaj kundërshtarëve politikë duke thëlluar antagonizmin mes tyre.

Kjo situatë ishte e paralajmëruar pasi Partia Socialiste që prej datës 8 qershor 2019, kur Presidenti i Republikës bëri publik vendimin e tij për anulimin e datës së zgjedhjeve e në vijim, vijoi fushatën elektorale duke refuzuar zbatimin e Dekretit të Presidentit të Republikës nr.11199, datë 10.06.2019.

Për më tepër, në retorikën publike përgjatë mitingjeve të zhvilluara nga Partia Socialiste mbizotëroi një gjuhë armiqësore dhe denigruese kundrejt Institucionit të Presidentit të Republikës.

Ndërkohë, koordinimi midis veprimtarisë politike të Partisë Socialiste, mazhorancës socialiste në Kuvend dhe KQZ, ishte qartësisht i dallueshëm²⁹.

Në të njëjtën ditë që Kuvendi kishte paralajmëruar dhe po zhvillonte seancën plenare për diskutimin e veprimtarisë së Presidentit të Republikës, datë 13.06.2019, ora 12:00, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mori në shqyrtim një çështje të ngritur nga Partia e Unitetit Kombëtar (PUK) (*aleat i Partisë Socialiste në zgjedhjet e 30 qershorit*), e cila po në të njëjtën ditë më datë 13.06.2019, kishte paraqitur në KQZ kërkesën e saj për t’u çregjistruar nga zgjedhjet vendore të datës 30.06.2019.

Kjo kërkesë u shqyrtua brenda ditës nga 4 anëtarët e KQZ (përfaqësues të Partisë Socialiste), të cilët me Vendimin nr. 836 datë 13.06.2019, ora 12:00, vendosën:

²⁹ Raporti përfundimtar i OSBE/ODIHR vëren se: “Atmosfera e pasigurisë ligjore dhe përplasia ndërmjet institucioneve kryesore minoi besimin e publikut për legjitimitetin e zgjedhjeve.”

“Rrëzimin e kërkesës së Partisë së Unitetit Kombëtar për çregjistrim nga zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019 dhe heqjen emrit nga fletët e votimit, të Partisë së Unitetit Kombëtar”.

Sipas përmbajtjes së këtij akti³⁰ KQZ, arsyeton se:

“ Përsa i përket vetë kërkesës, KQZ vlerëson më tej se objekti i saj përbën lëndë zgjedhore dhe është në kompetencë të KQZ për t’u shprehur me vendim. Kjo kërkesë, ka një premisë fillestare, që konsiston në analizën e bazës ligjore për zhvillimin e Zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019 (posaçërisht Dekretin nr.11199 datë 10.06.2019 të Presidentit të Republikës), si edhe një element thelbësor, që lidhet me të drejtën e subjektit zgjedhor për t’u çregjistruar nga procesi zgjedhor dhe heqjen e kredencialeve të tij nga fleta e votimit.

“I. Në lidhje me të parën, KQZ, i mbahet qëndrimit të bërë publik edhe më herët, në mbledhjen e datës 10.06.2019, me argumentet si më poshtë:

- i. Dekreti i Presidenti i Republikës, z. Meta, më datë 05.11.2018 ka nxjerrë Dekretin nr.10928 “Për zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore më datë 30 qershor 2019” me këtë përmbajtje: “Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të zhvillohen ditën e diel, më datë 30 qershor 2019”.
- ii. Më datë 10.06.2019, Presidenti i Republikës me Dekretin nr.11199 ka vendosur “Shfuqizimin e dekretit nr.10928, datë 5.11.2018 të Presidentit të Republikës “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”, duke anuluar datën 30 qershor 2019, si ditë e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë.”.

Dekreti nr.11199, datë 10.06.2019 i Presidentit të Republikës është botuar në Fletoren Zyrtare nr.84.

- iii. **Në datë 13.06.2019, Kuvendi i Republikës ka miratuar Rezolutën** “Mbi aktin e Presidentit të Republikës për shfuqizimin Dekretit Nr.10928, datë 05.11.2018 “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”. Kjo Rezolutë, megjithëse nuk ka forcë detyruese, pa asnjë dyshim ndihmon organet ligjzbatuese, në këtë rast Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për një interpretim, kuptim dhe zbatim sa më korrekt të legjislacionit të interesuar, duke qenë se vjen nga organi primar i hartimit dhe miratimit të Kushtetutës, Kodit Zgjedhor dhe Kodit të Procedurave Administrative³¹”.

Sipas këtij aryetimi, në vendim të KQZ, rezulton e provuar se të dyja organet si ai legjislativ (Kuvendi i Shqipërisë) edhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përbërja e të cilave mbizotërohet nga shumica përfaqësuese e Partisë Socialiste, kanë vepruar në mënyrë tepër të koordinuar, por jointucionale me njëri-tjetrin, me qëllim që Dekreti i Presidentit të Republikës nr.11199, datë

³⁰ <http://cec.org.al/vendime-2019/>

³¹ Bashkëlidhur Vendimi i KQZ.

10.06.2019, të mos zbatohet, por pa mundur që të shprehen ligjërisht me një akt për të cënuar apo shfuqizuar fuqinë detyruese të tij (dekretit).

Ky koordinim është lehtësisht i identifikueshëm. Në kundërshtim flagrant me ligjin, ky fakt pranohet hapur nga KQZ në Vendimin e saj nr. 836 dt. 13.06.2019, ora 12:00.

KQZ në arsyetimin e vendimmarrjes së saj të orës 12:00, i referohet një akti të Kuvendit të Shqipërisë, si Rezoluta, i cili në datë 13.06.2019, ora 12:00, nuk ekzistonte, pasi Rezoluta në këtë moment, nuk ishte votuar ende nga Kuvendi i Shqipërisë.

Siç rezulton nga praktika parlamentare Projekt-Rezoluta e paraqitur për diskutim është votuar nga Kuvendi i Shqipërisë, vetëm në orën 16:08 të datës 13.06.2019, pra 4 orë më pas se mbledhja e KQZ dhe vendimarrja e këtij organi që është realizuar po në datë 13.06.2019, ora 12:00³².

Në kushtet kur Rezoluta e Kuvendit nuk ekzistonte ligjërisht në momentin që KQZ e referon si një akt në vendimin e saj, tregon qartë se KQZ e dinte fare mirë paraprakisht se si do të votonte Kuvendi i Shqipërisë. Por kjo nuk e legjitimon KQZ që të përshkruajë në vendimin e saj, fakte, rrethana dhe të dhëna, të cilat në momentin e vendimmarrjes prej këtij organi nuk ekzistojnë³³.

KQZ, që prej datës 10 qershor 2019 kishte refuzuar publikisht zbatimin e Dekretit të Presidentit, por për këtë nuk kishte marrë asnjë vendim, pasi nuk mund ta realizonte ligjërisht. KQZ në gjithë këtë veprimtari të paligjshme dhe jashtë kompetencave të tij, kishte nevojë për një mbështetje që politikisht mund t'i vinte vetëm nga organi që e kishte zgjedhur atë në detyrë dhe që përfaqësonin në shumicë të njëjtin forcë politike (PS) pra nga Kuvendi i Shqipërisë.

Duhet të evidentohet se Rezoluta e Kuvendit në këtë rast nuk ka asnjë fuqi detyruese ligjore dhe kushtetuese si mbi Presidentin e Republikës dhe aktet e nxjerra prej tij, apo mbi veprimtarinë e KQZ-së.

Përveç kësaj, Kuvendi në këtë mosmarrëveshje juridike është njëra nga palët që mban interpretim të caktuar në lidhje me situatën juridike në fjalë. Duke e konsideruar veten “të lidhur” nga Rezoluta e Kuvendit, KQZ mban haptazi një qëndrim të njëanshëm dhe politik në interpretimin juridik të situatës³⁴.

Nga ana tjetër, një mosmarrëveshje mes dy organeve të parashikuara nga Kushtetuta, (Presidenti dhe Kuvendi) rreth interpretimit të dispozitave kushtetuese mbi kompetencat e tyre respektive nuk mund të kryhet nga një organ (KQZ apo Kolegji Zgjedhor) që nuk e ka këtë kompetencë kushtetuese.

Sipas nenit 131, pika ç të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese është institucioni i vetëm që vendos mbi mosmarrëveshjet e kompetencës midis pushteteve.

³² Bashkëlidhur fleta e rezultatit të votimit të Rezolutës së Kuvendit dt. 13.06.2019.

³³ Raporti përfundimtar i OSBE/ODIHR konstaton se: “Përballja politike çoi në pasiguri ligjore dhe shumë vendime të administratës zgjedhore u morën me objektivin politik për të siguruar zhvillimin e zgjedhjeve.”

³⁴ Raporti i OSBE/ODIHR konstaton me shqetësim se: “KQZ nuk veprroi me paanësi dhe pati raste kur shumica e anëtarëve të KQZ votuan sipas linjave politike.”

XVII. Njëanshmëria politike dhe paligjshmëria e KQZ.

Partia Socialiste pretendon se subjekti politik Bindja Demokratike ishte kandidat konkurrent në zgjedhjet e 30 qershorit 2019. Lidhur me këtë pretendim, duhet shënuar se regjistrimi i subjektit Bindja Demokratike në zgjedhje është i pavlefshëm për arsyet e mëposhtme.

Sipas nenit 64 të Kodit Zgjedhor, afati i fundit ligjor për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e 30 qershorit ishte data 23 prill 2019.

Sipas vendimit nr. 230, datë 27.04.2019, publikuar në faqen zyrtare³⁵ KQZ arsyetohet se:

“..... përfaqësuesi në emër dhe për llogari të Partisë “Bindja Demokratike”, ka paraqitur pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën dhe dokumentacionin për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore që do të zhvillohen më datë 30 qershor 2019, administruar me nr.2499 prot., datë 23.04.2019. Kërkesa e paraqitur është depozituar brenda afatit kohor, të parashikuar në pikën 1 të nenit 64, të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar.

Bashkëlidhur kërkesës Partia “Bindja Demokratike” ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë:

- *Vërtetimi nr. 1160/1. Prot, datë 26.04.2019, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 26.04.2019, nëpërmjet të cilit vërtetohet se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 8 datë 25.04.2019, vendim i cili nuk ka marrë formë të prerë, ka vendosur regjistrimin si person juridik të Partisë “Bindja Demokratike” në regjistrin e partive politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, Kryetar i përkohshëm është z. Astrit Patozi, emrin zyrtar, shkronjat nistore, adresën e partisë, dhe specimenin e vulës së partisë;*
- *emri, mbiemri dhe adresa e kryetarit të përkohshëm të partisë;*
- *shkronjat nistore dhe adresa e partisë;*
- *specimeni i vulës së partisë;*
- *emrin, mbiemrin dhe adresën e financierit të partisë (zj. Estela Kondura);*
- *emrin, mbiemrin dhe adresën e personit përgjegjës për komunikimin me KQZ-në (z. Fabian Topollaj);*

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pas verifikimeve përkatëse dhe konstatimit se, kërkesa dhe dokumentacioni i paraqitur nga Partia “Bindja Demokratike”, janë në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 64, të ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Të regjistrojë Partinë “Bindja Demokratike”, me kryetar z. Astrit Patozi, dhe shkronja nistore “BD”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019”.

³⁵ <http://cec.org.al/vendime-2019>

Sipas përmbajtjes të vendimit të sipërcituar të KQZ, rezulton e provuar në mënyrë të pakundërshtueshme se:

- Forca Politike “Bindja Demokratike”, me kryetar z. Astrit Patozi, në datë 23 prill 2019, mund të ketë paraqitur një kërkesë në KQZ për regjistrim si subjekt zgjedhor, por të pashoqëruar me dokumentacionin ligjor kryesor të kërkuar nga Kodi Zgjedhor, që është Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i formës së prerë, që regjistron personalitetin juridik të çdo partie politike sipas ligjit.
- Dokumentacioni i pretenduar si i paraqitur, në datë 23 prill 2019 në vendimin e KQZ, nuk ekzistonte, pasi Vendimi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është marrë më datë 25 prill 2019, dhe ende nuk kishte marrë formë të prerë, për t’u ekzekutuar si i detyrueshëm për zbatim.
- Forca Politike “Bindja Demokratike”, më datë 23 prill 2019, nuk gëzonte personalitet juridik, për të kërkuar regjistrim si subjekt zgjedhor, apo për t’u regjistruar si e tillë, pasi kjo forcë politike në datë 23 apo 27 prill 2019 nuk ekzistonte si Parti Politike, sipas kërkesave të ligjit nr.8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike”, i ndryshuar.

Kjo vendimmarrje e KQZ³⁶ dëshmon dhe një herë njëanshmërinë dhe veprimtarinë e paligjshme të KQZ përgjatë gjithë kësaj periudhe.

XVIII. Zhbalancimi politik i KQZ dhe veprimtaria antiligjore e njëanshme dhe e pakontrolluar e këtij organi.

Kodi Zgjedhor përcakton se KQZ përbëhet nga 7 anëtarë, ndërkohë që aktualisht KQZ funksionon vetëm me 5 anëtarë, katër prej të cilëve janë përfaqësues të Partisë Socialiste.

Sipas Kodit Zgjedhor KQZ duhet të funksionojë si një institucion i balancuar politikisht. Në momentet kur kjo balancë prishet, trysnia e forcave politike ndaj përfaqësuesve të tyre në detyrë rritet, duke diktuar edhe vendimmarrjen e këtij organi. Për pasojë KQZ kthehet automatikisht në një seksion politik të mazhorancës vendimmarrëse, siç është rasti aktual.

Rrjedhimisht i gjithë procesi administrues dhe vendimarrës zgjedhor prodhon një produkt fals, në dukje formal, ndërsa në përmbajtje tërësisht në kundërshtim me frymën e Kushtetutës dhe të ligjit. Kjo tregon edhe një herë se sa rëndësi ka funksionimi sipas ligjit i këtij organi.

Njëanshmëria politike në vendimmarrjen e KQZ-së u evidentua edhe kur dy forcat politike parlamentare të opozitës (Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim), paraqitën kërkesat respektive për të emëruar anëtarët dhe sekretarët e tyre në KZAZ, të emëruar më herët kryesisht nga KQZ.

³⁶ Raporti i OSBE/ODIHR pohon se: “KQZ regjistroi Bindjen Demokratike (PBD) si subjekt zgjedhor më 27 prill, megjithëse kjo e fundit u regjistrua si parti politike vetëm më 25 prill, me vendim gjykate duke u bërë i formës së prerë në 10 maj.... KQZ nuk kërkoj që PBD të mbledhë nënshkrime mbështetëse. KQZ e interpretoi ligjin në një mënyrë tepër të gjerë dhe nganjëherë në kundërshtim me praktikën e mëparshme të saj, duke cënuar sigurinë juridike.

Edhe pse kërkesa mbështetej në nenet 28, 29 të Kodit Zgjedhor, KQZ i rrëzoi ato, duke i shmangur tërësisht forcat politike opozitare nga procesi i administrimit dhe realizimit të procesit zgjedhor në nivel vendor³⁷.

Kjo vendimmarrje e KQZ e datës 23 maj 2019, ishte në kundërshtim me Kodin Zgjedhor dhe i shërbeu edhe më shumë thellimit të konfliktit dhe antagonizmit mes mazhorancës dhe opozitës.

XIX. Procesi fiktiv i Kolegjit Zgjedhor i pavlefshëm në raport me Dekretin nr. 11199.

Veprimtaria fiktive e Kuvendit dhe KQZ vijoi edhe më tej. Si rezultat i kësaj vendimmarrjeje të KQZ, Partia e Unitetit Kombëtar (aleate e Partisë Socialiste në zgjedhjet e 30 qershorit), e kundërshtoi në mënyrë fiktive Vendimin nr.836 dt. 13.06.2019 të KQZ-së në Kolegjin Zgjedhor.

Objekt i kërkimit të Partisë së Unitetit Kombëtar (PUK) përpara Kolegjit ishte: “Kundërshtimi i Vendimit nr.836 dt 13.06.2019 të KQZ, me të cilin ishte vendosur rrëzimi i kërkesës së kësaj partie për t’u çregjistruar nga zgjedhjet e 30 Qershorit 2019”, që tashmë ishin anuluar nga Presidenti i Republikës.

Kolegji Zgjedhor më datë 24.06.2019, bëri publik përfundimin e shqyrtimit të kësaj kërkesë, ku me Vendimin 12, datë 24.06.2019, vendosi: Rrëzimin e padisë së palës paditëse Partia e Unitetit Kombëtar.

Me vendimmarrjen e tij, Kolegji Zgjedhor, nuk preku aspak vlefshmërinë e Dekretit të Presidentit të Republikës nr.11199, datë 10.06.2019, edhe për faktin se shqyrtimi i dekretive të Presidentit nuk hyn në kompetencat dhe juridiksionin e Kolegjit Zgjedhor.

Gjykata Kushtetuese, është i vetmi organ i mandatar për të vendosur mbi kushtetutshmërinë e dekretive presidenciale, ndërsa Kolegji Zgjedhor ka mandat të mbikqyrë ligjshmërinë e procesit zgjedhor³⁸.

Ky vendim i Kolegjit Zgjedhor nuk ka urdhëruar në dispozitivin e tij asnjë detyrim që të krijojë pasoja juridike mbi Dekretin nr.11199, datë 10.06.2019 dhe Institucionin e Presidentit të Republikës, e rrjedhimisht edhe mbi faktin e anulimit të datës 30 qershor si ditë e zhvillimit të zgjedhjeve.

Gjithashtu në këtë proces gjyqësor Institucioni i Presidentit të Republikës nuk është thirrur nga Kolegji Zgjedhor për të qenë palë në proces. Në zbatim të nenit 145, 155, 156, 158 të Kodit

³⁷ Raporti i OSBE/ODIHR shpreh shqetësimin se: “Mospranimi i kërkesës së opozitës për zëvendësimin e komisionerëve të KZAZ të emëruar me herët nga KQZ, u bazua në një vendim “individual” të KQZ. Këtij vendimi iu dha më pas efekt “normativ”, pasi KQZ udhëzoi KZAZ që gjithashtu të refuzojnë emërimin e kandidatëve të PD dhe LSI për QVN dhe GN. Vendimet normative merren me shumicë 2/3. Sipas Kodit të Praktikave të Mira të Çështjeve Zgjedhore të Komisionit të Venecias 2002, “Është e dëshirueshme që vendimet e komisioneve zgjedhore të merren me shumicë të cilësuar ose me konsensus”.....interpretimi i ligjit nga KQZ, e la administratën zgjedhore politikisht të zbalancuar, çka solli mungesë besimi për të gjitha nivelet e komisioneve”.

³⁸ Siç evidenton dhe raporti i OSBE/ODIHR në gjetjet e tij: “Gjykata Kushtetuese, është i vetmi organ i mandatar për të vendosur mbi kushtetutshmërinë e dekretive presidenciale, ndërsa Kolegji Zgjedhor ka mandat të mbikqyrë ligjshmërinë e procesit zgjedhor.”

Zgjedhor dhe rregullave të Kodit të Procedurës Civile, vendimet e Kolegjit Zgjedhor kanë efekt vetëm përkundrejt palëve në proces dhe vetëm për atë çka është vendosur midis këtyre palëve: pra midis KQZ dhe aleatit të Partisë Socialiste, PUK.

Sipas nenit 145 të Kodit Zgjedhor, Kolegji Zgjedhor në Shqipëri shqyrton këto lloj ankimesh:

- Ankimet e çdo subjekti zgjedhor kundër vendimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kur ato cenojnë interesat e tyre të ligjshëm;
- Ankimet e individëve ose partive politike, të cilëve u është refuzuar kërkesa për regjistrim si subjekt zgjedhor;
- Ankimet e subjekteve zgjedhore për mosmarrje të vendimit brenda afatit ligjor nga KQZ-ja;
- Ankimet e çdo partie politike, koalicioni, kandidatit, organizate joqeveritare shqiptare ose e huaj, si dhe organizatat ndërkombëtare të specializuara të cilëve u është refuzuar kërkesa për akreditimin e vëzhguesve në zgjedhje.

Sipas Kodit Zgjedhor, Kolegji Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë nuk ka kompetencë të shqyrtojë vlefshmërinë e Dekreteve të Presidentit, pasi këtë të drejtë nuk ia njej Kushtetuta, Kodi Zgjedhor dhe as ndonjë ligj tjetër në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Në mungesë të Gjykatës Kushtetuese, e cila do të duhej të shqyrtonte çdo pretendim mbi kushtetutshmërinë e Dekretit të Presidentit të Republikës, Partia Socialiste dhe KQZ, duke përdorur PUK inskenuan një veprim procedural për të anatemuar indirekt vendimin e Kreut të Shtetit, për të ndërtuar një operacion propagandistik brenda e jashtë vendit, duke krijuar perceptimin publik se Dekreti i Presidentit u shfuqizua nga Kolegji Zgjedhor.

Ndërmarrja e një procesi në Kolegjin Zgjedhor nga PUK është vetëm një përpjekje indirekte dhe pa vlerë juridike e Partisë Socialiste për të justifikuar politikisht paligjshmërinë e veprimtarisë së anëtarëve të saj në KQZ³⁹.

Kjo veprimtari e koordinuar e KQZ me Partinë Socialiste ishte e pritshme që të dështonte ligjërisht, sepse nuk kishte asnjë mundësi ligjore që të ndodhte ndryshe.

Dekreti i Presidentit nr.11199, datë 10.06.2019 për anulimin e datës 30 qershor si ditë e zhvillimit të zgjedhjeve për pushtetin vendor, është marrë në mbështetje të plotë me Kushtetutën dhe parimet themelore të mbrojtura prej saj. Për pasojë, vetëm Gjykata Kushtetuese mund të shqyrtojë kushtetutshmërinë e Dekretit të Presidentit të Republikës. Dekreti i Presidentit të Republikës nr.11199, datë 10.06.2019, referuar;

- dispozitave kushtetuese mbi të cilat është mbështetur nxjerrja e këtij dekreti;
- veprimtarisë tërësisht kushtetuese të Kreut të Shtetit;
- parimeve kushtetuese dhe të drejtave e liritë themelore për mbrojtjen e të cilave ky akt është nxjerrë;
- marrëdhënieve juridiko-shoqërore që ky akt rregullon,

³⁹ Raporti i OSBE/ODIHR shprehet për këtë rast se: “Sa i përket kërkesës së PUK për ç’regjistrimin nga zgjedhjet dhe vendimet përkatëse të KQZ dhe Kolegjit Zgjedhor, ODIHR shpreh shqetësimin për i) njëanshmërinë e KQZ dhe rastet kur shumica e anëtarëve të KQZ votuan sipas linjave politike; gjykatësit e Kolegjit Zgjedhor janë subjekte të procesit të vetingut, çka mund të ndikojë sigurinë e mandatit të tyre dhe si pasojë të çënojë pavarësinë e tyre.”

- si dhe referuar argumentave tërësisht kushtetutes mbi bazën e të cilëve është marrë,

është një akt me natyrë krejtësisht të veçantë juridiko-kushtetuese dhe si i tillë, askush tjetër veç Gjykatës Kushtetuese nuk mundet të shqyrtojë vlefshmërinë dhe kushtetutshmërinë e tij.

Dekreti i Presidentit të Republikës me nr.11199, datë 10.06.2019, deri në ditën e sotme, nuk është ndryshuar; nuk është anuluar dhe nuk është shfuqizuar nga Kolegji Zgjedhor apo ndonjë Gjykatë tjetër në Republikën e Shqipërisë.

Ky Dekret nuk është kundërshtuar deri në këto momente nga ndonjë forcë politike apo nga ndonjë subjekt tjetër politik ose jopolitik përpara ndonjë gjykate në Republikën e Shqipërisë, përfshi këtu edhe Kolegjin Zgjedhor.

Sa më sipër, referuar dispozitave Kushtetuese që përcaktojnë se Presidenti i Republikës është autoriteti i vetëm kushtetues që cakton datën e zgjedhjeve, si dhe faktit që Dekreti i Presidentit nr.11199, datë 10.06.2019 për anulimin e zgjedhjeve për pushtetin vendor të datës 30 qershor, nuk është prekur dhe nuk është cenuar deri në ditët e sotme nga asnjë Gjykatë vendase dhe ndërkombëtare, rikonfirmon dhe një herë faktin se, ky akt i Presidentit të Republikës i marë bazuar tërësisht në argumenta kushtetues është në fuqi dhe i detyrueshëm për zbatim nga të gjithë.

Për pasojë, e gjithë veprimtaria e organizuar dhe zhvilluar nga KQZ deri më tani, e frymëzuar dhe mbështetur nga Partia Socialiste dhe e orientuar nga Kuvendi i Shqipërisë, është një proces i paligjshëm, antikushtetues dhe që nuk krijon asnjë pasojë juridike.

Data 30 qershor 2019 nuk ekziston ligjërisht si datë e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, pasi akti i Presidentit të Republikës që e caktonte këtë datë është shfuqizuar nga vetë autoriteti kushtetues që e ka nxjerrë atë (Presidenti i Republikës).

Gjithashtu, në kushtet kur Kuvendi ka formalizuar qëndrimin e tij mbi veprimtarinë e Presidentit të Republikës me votimin e Rezolutës më datës 13 qershor 2019, si dhe pretendon shkelje flagrante të Kushtetutës, ky pretendim duhet shqyrtuar vetëm nga Gjykata Kushtetuese.

Ndërkohë në rastin në fjalë, pretendimi për shkelje flagrante të Kushtetutës është analizuar/shqyrtuar, në dijeni të plotë të natyrës së pretendimit, nga dy organe që nuk janë parashikuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

KQZ dhe Kolegji Zgjedhor mund të shprehen për shkelje të Kodit Zgjedhor, por jo për shkelje të Kushtetutës.

Siç e ka analizuar edhe Komisioni i Venecias në studimin e lartpërmendur CDL-AD(2010)039rev., Republika e Shqipërisë, me sistemin kushtetues që ka zgjedhur, i përket sistemit të kontrollit të përqendruar kushtetues⁴⁰.

⁴⁰ Për këtë sistem shih nga ideatori i tij, Hans Kelsen, *La garantie juridictionnelle de la Constitution, Revue de Droit Public*, 1928, vol. 44, pp. 197-257.

Kjo do të thotë që kur ka një pretendim mbi shkelje të Kushtetutës, organi që e ka në shqyrtim çështjen në të cilën ngrihet ky pretendim e pezullon atë dhe ia dërgon për interpretim organit qendror/përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës – Gjykatës Kushtetuese.

Kjo nuk është asgjë tjetër veçse detyrimi që i vë çdo organi juridiksional nenit 145 § 2 i Kushtetutës i cili parashikon se:

“Kur gjyqtarët çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën, nuk i zbatojnë ato. Në këtë rast, ata pezullojnë gjykimin dhe ia dërgojnë çështjen Gjykatës Kushtetuese. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për të gjitha gjykatat.”

Të paktën Kolegji Zgjedhor e kishte për detyrë që të mos argumentonte mbi vlefshmërinë apo jo të Dekretit për aq kohë sa kishte një pretendim për shkelje ‘flagrante’ të Kushtetutës me anë të këtij akti.

Për të gjitha këto arsye, qëndrimi i Presidentit të Republikës është se arsyetimet e KQZ dhe të Kolegjit Zgjedhor janë të pambështetura në sistemin kushtetues dhe ligjor shqiptar dhe absurde sipas nocioneve themelore të sistemeve ligjore të së drejtës.

I gjithë debati mbi kushtetutshmërinë apo jo të Dekretit nr. 11199, datë 10.06.2019 të Presidentit të Republikës do të mund të ishte zgjidhur fare lehtë nga Gjykata Kushtetuese me një vendim të saj. E gjithë kjo situatë është krijuar nga mungesa e Gjykatës Kushtetuese.

XX. Historiku i shtyrjes së zgjedhjeve nga Presidenti i Republikës në Shqipëri.

Zhvillimi i proceseve zgjedhore në Republikën e Shqipërisë si për Kuvendin ashtu dhe për organet e qeverisjes vendore ka krijuar historikun e vet, ku nuk mungojnë rastet e precedentëve të shtyrjes së datës së zgjedhjeve nga Presidenti i Republikës, në varësi të rrethanave, për të përmbushur një qëllim të ligjshëm dhe për konsolidimin e demokracisë së brishtë shqiptare.

Precedenti i parë i shtyrjes së procesit zgjedhor në Shqipëri ka filluar që në hapat e parë të ndryshimeve thelbësore të sistemit qeverisës në vitet 1990-1991, momenti i parë që i hapi rrugë demokracisë pluraliste dhe ekonomisë së tregut në vendin tonë.

Ish-Kryetari i Presidiumit të Kuvendit Popullor Ramiz Alia me Dekretin nr.7433, datë 01.12.1990 kishte përcaktuar se “Zgjedhjet e deputetëve të Kuvendit Popullor për Legjislaturën e 12-të të bëhen më datën 10 shkurt 1991, ditën e diel”. Ky dekret është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 8, datë 20.12.1990.

Ish-Presidenti Ramiz Alia, udhëheqësi i fundit i sistemit komunist në Shqipëri, reflektoi në koherencë me ndryshimet e mëdha politike që po ndodhnin në gjithë Europën Lindore dhe më datë 17.01.1991 vendosi për shtyrjen e datës së zgjedhjeve të përgjithshme të planifikuara për t’u mbajtur më datë 10 shkurt 1991.

Vendimi për shtyrjen e datës së zgjedhjeve u bë për t’u dhënë mundësi forcave politike opozitare të sapokrijuara që të merrnin pjesë në zgjedhjet e përgjithshme, edhe pse ato kërkonin ndryshimin dhe përmbysjen e lidërshipt komunist në Shqipëri.

Precedenti i parë për shtyrjen e zgjedhjeve në datë 31 mars 1991 mundësoi parlamentin e parë pluralist në Shqipërinë postkomuniste.

Raste të tjera të shtyrjes së datës së zgjedhjeve, për Kuvendin apo pushtetin vendor në Republikën e Shqipërisë, kanë ndodhur në 2006, 2007, 2017⁴¹.

Si konkluzion i shqyrtimit të këtyre precedentëve ndër vite, rezulton se shtyrjet e proceseve zgjedhore të përgjithshme apo vendore në Republikën e Shqipërisë, janë diktuar si pasojë e rrethanave të veçanta politike, të klimës së mosbesimit midis palëve, konfliktit politik, dhe situatave të tensionuara sociale. Në të gjitha rastet, ndërhyrjet e Presidentit të Republikës kanë qenë të domosdoshme si autoritetit i vetëm kushtetues për të nxjerrë një Dekret të ri për shtyrjen e datës së garës zgjedhore.

Historiku i antagonizmit politik në Shqipërinë e pas-'90 tregon se në mungesë të dialogut të ndërmjetësuar mes palëve, konfliktet kanë kulmuar gjithmonë me përplasje civile. Veçanërisht, gjatë manifestimeve politike, ku janë shënuar edhe viktima, historiku na tregon se situata ka dalë tërësisht jashtë kontrollit të palëve.

XXI. Raste analoge të shtyrjes së datës së zgjedhjeve – Standardet më të rëndësishme se data

Presidenti i Republikës ka vlerësuar edhe raste analoge të shtyrjes së zgjedhjeve gjatë krizave politike në vende të rajonit dhe më gjerë.

Për të arritur një kuptim edhe më tërësor të situatave të ngjashme në vendet fqinje, me të cilat kemi elementë ngjashmërie politike, kulturore dhe gjeografie, Presidenti i Republikës sjell në vëmendje rastin e Republikës së Maqedonisë Veriore në vitin 2016.

Republika e Maqedonisë Veriore u gjend në një krizë të ngjashme zgjedhore, ku me ndërhyrjen e ambasadës së SHBA-së dhe Delegaonit të BE-së, u arrit shtyrja e zgjedhjeve.

Në letrën ⁴² e përfaqësuesve të SHBA-së dhe BE-së, të datës 21 shkurt 2016, drejtuar kryeministrit të kohës të RMV Emil Dimitriev, evidentohet se **kushtet e zhvillimit të zgjedhjeve ishin më të rëndësishme se data e caktuar:**

“kushtet e nevojshme për organizimin e zgjedhjeve të besueshme dhe shtyrja në një datë e mëvonshme do të rivendoste besimin e qytetarëve në procesin zgjedhor, do të sigurojë një konkurrencë të drejtë dhe do ta zhvendoste vendin përtej krizës politike - si dhe do të sigurojë një proces zgjedhor të besueshëm në të cilin të gjithë qytetarët dhe partitë duhet të marrin pjesë lirisht.”

Ky argument thelbësor u bë shkak për shtyrjen 2-herë të datës së zgjedhjeve në RMV. Rezultati i pritshëm i këtij veprimi ishte realizimi i një procesi demokratik, gjithëpërfshirës dhe të besueshëm zgjedhor, që do të ulte tensionet politike dhe zgjidhte krizën e përfaqësimit.

⁴¹ Bashkëlidhur historiku i plotë i këtyre rasteve.

⁴² Bashkëlidhur letra e SHBA dhe BE drejtuar Kryeministrit të Maqedonisë.

Ka patur edhe shumë raste të tjera kur zgjedhjet lokale, rajonale dhe të përgjithshme janë shtyrë më vende të ndryshme të botës. Sipas Bernard Maligner, ekspert ligjor në të drejtën zgjedhore, "shtyrja e zgjedhjeve duhet të motivohet nga interesi i përgjithshëm" (pour des «impératifs d'intérêt général»).⁴³

XXII. Veprimtaria e Presidentit të Republikës për zgjidhjen e krizës pas datës 10 qershor 2019.

Ndërmjet datave 10-26 qershor 2019, Presidenti i Republikës ka vijuar përpjekjet intensive për afrimin e palëve dhe për caktimin e një date të re për realizimin e zgjedhjeve gjithëpërfshirëse, të lira, të ndershme dhe demokratike, në kushte të qeta dhe të sigurta.

Gjatë daljeve publike në këtë periudhë, Presidenti ka evidentuar domosdoshmërinë e dialogut konstruktiv gjithëpërfshirës, duke ofruar ndërmjetësim për zgjidhje sa më të shpejtë të krizës me qëllim ruajtjen e demokracisë, pluralizmit politik dhe shtetit të së drejtës. Pjesë e kësaj zgjidhjeje do të duhej të ishte edhe dakordësimi mbi një datë të re për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore.

Konkretisht mesazhet dhe thirrjet e Presidentit të Republikës, konsistonin në përmbajtjen si më poshtë:

- *Vendimmarrja e Presidentit të Republikës për shfuqizimin e Dekretit për zhvillimin e zgjedhjeve më datë 30 qershor u bë e domosdoshme në kushtet e përshkallëzimit të ndërsjelltë dhe të vullnetshëm të qëndrimeve dhe aksioneve historike të të dy palëve politike për rritjen e tensionit në vend, dhe rrezikut për të kulmuar në përplasjen mes tyre më 30 qershor.*
- *Vendimi për shfuqizimin e dekretit për zhvillimin e zgjedhjeve më datë 30 qershor, është marrë me përgjegjshmëri të plotë dhe në vlerësim të të gjithë rrethanave, fakteve, dhe të informacioneve të siguruara në cilësinë e Kreut të Shtetit se, më datë 8 qershor mund të provokohej një konflikt destabilizues me pasojë për jetën, dhe shëndetin e qytetarëve, sigurinë publike dhe rendin kushtetues në vend.*
- *Të dyja palët e kishin shpallur datën e caktuar nga Presidenti për zgjedhjet vendore, pra 30 qershorin, si ditën kur do të përballeshin në një betejë force dhe jetë a vdekje midis tyre. Ndaj, me bindje të plotë dhe të palëkundur, edhe me përgjegjësinë si Kryetar i Këshillit të Sigurisë Kombëtare, mora vendimin e duhur për të shmangur një konflikt civil në vend dhe për të shpëtuar demokracinë dhe të ardhmen europiane të vendit.*
- *Dekreti i Presidentit të Republikës i është dërguar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, i cili ka për detyrë dhe përgjegjësi ta zbatojë atë. Çdo anashkalim i detyrave dhe përgjegjësisë të veta nga ana e këtij organi është i patolerueshëm nga ligji.*

⁴³ Bernard Maligner, « Qu'est-ce qu'un faible écart de voix dans la jurisprudence récente du Conseil constitutionnel et du Conseil d'Etat ? » in Mélanges en l'honneur de J.-C. Masclet, Publication de la Sorbonne, 2013, p. 298 et « Le Conseil constitutionnel, juge des opérations et des finances électorales », Nouveaux Cahiers du Conseil constitutionnel n° 41, oct. 2013, p. 47

- Çdo subjekt politik ose jopolitik, i cili nuk është dakord me vendimmarrjen e Presidentit të Republikës, apo kundërshton kompetencat që Presidenti ka ushtruar, është i lirë që të ngrejë pretendimet e tij në Gjykatën Kushtetuese, apo pranë çdo gjykate tjetër që ai vlerëson se mund të shqyrtojë pretendimet e tij mbi këtë çështje;
- Republika nuk është monopartitizëm, por zgjedhje pluraliste, të lira, të ndershme, me mundësi dhe shanse të barabarta për të gjithë. Republika nuk mund të jetë gjithashtu as kapje totale e institucioneve nga ana e mazhorancës, dhe as delegitimim i tyre nga ana e opozitës.
- Presidenti i Republikës i siguron qytetarët e Republikës së Shqipërisë se, zgjedhjet për pushtetin vendor do të zhvillohen në një datë të mëvonshme përtej 30 qershorit dhe gjithmonë brenda një afati të arsyeshëm, në respekt me frymën e Kushtetutës. Ato do të duhet të jenë të lira, të ndershme, demokratike dhe konkurruese. Presidenti i Republikës i siguron qytetarët e Shqipërisë se, ata do të votojnë, në një situatë të qetë dhe në mënyrë të lirë e të ndershme.
- Pikërisht për caktimin edhe të kësaj date të re, Presidenti, prej datës 12 qershor 2019 ka nisur një proces të gjerë konsultimi me të gjitha forcat politike në vend. Presidenti do të shprehet me Dekret për caktimin e një date të re.
- Presidenti u bën thirrje palëve që ta lexojnë bashkarisht dhe me seriozitet Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të thellohen dhe të shfrytëzojnë këtë hapësirë kohore që u kam ofruar për gjetjen një zgjidhjeje urgjente për krizën, përfshirë dakordësimin e një date të re për pjesëmarrjen e të gjithëve në zgjedhjet vendore.
- Presidenti i Republikës fton palët të kuptojnë domosdoshmërinë e zgjidhjes së shpejtë dhe përmes dialogut të kësaj krize, si akti i vetëm që do të favorizonte çeljen sa më parë të negociatave të anëtarësimit me Bashkimin European.
- Këshillat aktualë Bashkiakë do të ushtrojnë funksionet e tyre, deri në krijimin e këshillave pasardhës, përbërja e të cilëve, do të formatohet nga zgjedhjet e reja që do të realizohen.
- Gjithashtu edhe, Kryetarët aktualë të Bashkive do të ushtrojnë mandatin e tyre derisa sa Kryetarët e rinj që do të zgjidhen, do të bëjnë betimin për funksionet që ata do të marrin. Kjo nuk është një zgjatje e mandatit të organeve të qeverisjes vendore që bëhet nga Presidenti i Republikës, por një detyrim dhe e drejtë që përcaktohet nga ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
- Presidenti i Republikës ripërsërit thirrjen ndaj të gjitha palëve politike, që ta shfrytëzojnë maksimalisht këtë hapësirë kohore për të reflektuar dhe t’i përgjigjen ftesës së Presidentit për dialog, për të gjetur së bashku një zgjidhje urgjente për krizën, përfshirë dakordësimin e një date të re, për pjesëmarrjen e të gjithëve në zgjedhjet vendore.
- Më 20 qershor 2019, u bënë dhjetë ditë që është në fuqi dekreti i Presidentit të Republikës për anulimin e datës së zgjedhjeve më 30 qershor, me qëllim qetësimin e situatës dhe krijimin e mundësive për dialog, që do të normalizonte situatën politike dhe do të krijonte mundësinë për një datë të re të zgjedhjeve vendore, gjithëpërfshirëse dhe demokratike.

- *Nuk është kurrësi momenti për prova force, për retorikë përçarëse dhe provokuese, por për maturi dhe përgjegjshmëri të lartë për interesat kombëtare të vendit dhe vazhdimësinë e integritetit evropian, që është objektiv kombëtar i të gjithë shqiptarëve.*
- *Insistoj me forcë për rëndësinë e dialogut mes palëve dhe njëkohësisht gatishmërinë time për të kontribuar për një zgjidhje sa më të shpejtë.*
- *Presidenti i Republikës garanton edhe njëherë popullin shqiptar, se është në detyrë dhe i gatshëm të ndër marrë të gjitha vendimet e rëndësishme që do të diktojnë situata dhe interesi më i mirë i vendit, në përputhje me kompetencat që i jep Kushtetuta dhe me betimin e tij solemn për t'i shërbyer interesit të përgjithshëm dhe përparimit të të gjithë popullit shqiptar!*

Në datë 12 qershor 2019, Presidenti i Republikës zhvilloi takime me kryetarët dhe përfaqësuesit e partive opozitare të Grupimit të Qendrës së Djathtë, subjekte politike opozitare pjesë e opozitës së bashkuar të udhëhequr nga Partia Demokratike, të cilët i shprehën Presidentit se data e re e zgjedhjeve do të përcaktohet pas një marrëveshjeje politike, nëse Partia Socialiste dhe Partia Demokratike do t'i përgjigjen pozitivisht ftesës së Presidentit.

Presidenti i Republikës realizoi një takim edhe me Kryetarin e Partisë Demokracia Sociale (në aleancë me Partinë Socialiste), ish-Ministrin e Punëve të Jashtme z.Paskal Milo, i cili ishte shprehur publikisht se kriza e rëndë politike mund të shkaktojë një shpërthim social të pakontrolluar.

Edhe pse përgjatë 10 - 26 qershorit Presidenti i Republikës bëri të gjitha përpjekjet e mundshme për dialog mes palëve politike (*pozitë-opozitë*) ai evidentoi se palët sërish ishin jashtë çdo logjike për bashkëpunim reciprok.

Palët vijuan sjelljet provokuese që kërcënonin paqen sociale dhe mbarëvajtjen e jetës shoqërore në vend.

Nëpërmjet shkresës nr.2008 prot, datë 26.06.2019, Presidenti i Republikës ftoi përsëri në takim Kryetarin e Partisë Socialiste dhe Kryetarin e Partisë Demokratike për të biseduar për situatën politike në vend.

Kryeministri Rama refuzoi takimin me Presidentin përmes komunikimit në rrjetet sociale. Ndërsa Zoti Lulzim Basha, Kryetar i Partisë Demokratike dhe udhëheqës i Opozitës së bashkuar u takua me Presidentin datë 27 qershor 2019, ora 09:00.

Në të njëjtën ditë, Presidenti i Republikës priti në një takim:

- Kryetarët dhe përfaqësuesit e partive të Grupimit të Qendrës së Djathtë, subjekte politike opozitare pjesë e opozitës së bashkuar të udhëhequr nga Partia Demokratike;
- Nënkryetarin e Lëvizjes Socialiste për Integritet, z. Petrit Vasili, parti opozitare pjesë e opozitës së bashkuar e udhëhequr nga Partia Demokratike;
- Kryetarin e Partisë Demokracia Sociale, parti në aleancë me Partinë Socialiste, Ish-Ministrin e Punëve të Jashtme z. Paskal Milo;

- Kryetarin e Partisë për Drejtësi Integrim dhe Unitet, z. Shpëtim Idrizi.

Presidenti i Republikës diskutoi mbi situatën kritike në vend dhe kërkoi mendim për caktimin e datave të mundshme për zhvillimin e zgjedhjeve për organet e pushtetit vendor.

Presidenti theksoi se zgjedhjet duhet të zhvillohen brenda një kohe sa më të shpejtë, që garanton jo vetëm mundësinë ligjore për regjistrimin e partive si konkurrencte në këto zgjedhje, por dhe mundësinë procedurale që ato të jenë administratore të procesit për të emëruar edhe anëtarët e komisioneve zonale të administrimit të procesit zgjedhor sipas procedurave të Kodit Zgjedhor.

Presidenti ka realizuar gjithashtu takime përfaqësues të Trupit Diplomatik të akredituar në Tiranë si dhe me Ambasadoren Audrey Glover, drejtuese e misionit të vëzhguesve të OSBE/ODIHR-it në zgjedhjet lokale 2019 në Shqipëri, me të cilët diskutoi mbi problematikën politike, kushtetuese, përfaqësimit dhe institucionale në vend.

XXIII. Caktimi i datës 13 tetor 2019 për zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Presidenti i Republikës ka përgjegjësinë kushtetuese të caktojë një datë zgjedhjesh për organet e qeverisjes vendore, duke iu respektuar periodicitetin kushtetues të zhvillimit të tyre, në mënyrë që të gjithë shqiptarët të ushtrojnë të drejtën e votës, të kenë mundësi të zgjedhin të qetë, në mënyrë demokratike dhe të pandikuar nga sjellja apo trysnia e aktorëve politikë.

Duke analizuar të gjithë situatën e krijuar, Presidenti i Republikës, në mbështetje të neneve: 1/3, 3, 4, 5, 15, 45/1 e 4, 86/1, 92 shkronja “gj”, 93, 109 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, vendosi që, zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të caktohen për t’u zhvilluar ditën e diel, në datën 13 tetor 2019.

Ky vendim është rrjedhojë dhe i mbështetur kryesisht mbi të njëjtat arsye kushtetuese mbi të cilat u miratua Dekreti nr.11199, datë 10.06.2019, dhe përmbyll kështu një proces kushtetues të nisur me këtë akt.

Në vendimmarrjen e Presidentit, për caktimin e datës 13 tetor 2019 si ditë zgjedhjesh për organet e qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, u vlerësuan edhe këto çështje;

Së pari, përcaktimi i datës 13 tetor 2019, është dita më e afërt për të organizuar zgjedhje të përgjithshme vendore gjithëpërfshirëse, pasi sipas afateve procedurale në fuqi, kjo datë krijon mundësinë që të gjithë subjektet politike jo vetëm të shprehin vullnetin e tyre për të marrë pjesë në zgjedhje si konkurrent, por edhe të jenë pjesë e organeve në administrimin e procesit zgjedhor.

Pas Dekretimit të datës 13 tetor 2019, si ditë e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, forcave politike që dëshirojnë të marrin pjesë në zgjedhje duhet t’u jepet mundësia për të qenë jo vetëm pjesëmarrës konkurrues në zgjedhje, por edhe të kenë përfaqësuesit e tyre në Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor.

Regjistrimi si subjekt zgjedhor, apo propozimi i kandidaturave dhe krijimi i këtyre komisioneve zonale kalon nëpërmjet një procedure të caktuar sipas Kodit Zgjedhor.

- Sipas nenit 28 pika 1 të Kodit Zgjedhor KQZ, duhet të ngrejë Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor, jo më vonë se 90 ditë para datës së zhvillimit të zgjedhjeve, ndërkohë që sipas pikës 2 të këtij neni, partitë politike duhet të propozojnë kandidaturat përkatëse për anëtarë të KZAZ, jo më vonë se 15 ditë para afatit të parashikuar më sipër.
- Gjithashtu sipas nenit 64/1 të Kodit Zgjedhor çdo subjekt politik i interesuar për të konkurruar në zgjedhje është i detyruar që jo më vonë se 70 ditë përpara datës së zhvillimit të zgjedhjeve të parashtrijë përpara KQZ, kërkesën për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor.
- Sipas nenit 65 të Kodit Zgjedhor, partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhore duhet të reklamojnë vullnetin e tyre të shprehur me shkrim për t'u regjistruar në KQZ si koalicionë zgjedhore jo më vonë se 60 ditë përpara datës së zgjedhjeve.
- Sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor, çdo subjekt zgjedhor apo koalicion zgjedhor i regjistruar duhet të paraqesë listat e kandidatëve të tyre jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve.

Referuar këtyre kërkesave të Kodit Zgjedhor, dhe përllogaritjeve të afateve të përcaktuara në dispozitat e mësipërme, diktohet se nga data 27 qershor 2019, zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore nuk mund të zhvillohen më parë se data 13 tetor 2019.

Kjo sepse në këtë mënyrë të gjitha forcave politike që dëshirojnë të marrin pjesë në këto zgjedhje, u jepet mundësia për të qenë jo vetëm pjesëmarrës si konkurrentë në zgjedhje, por edhe të paraqesin kërkesat për të emëruar përfaqësues në Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor, për të qenë kështu administrator real të procesit zgjedhor sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor.

Data 13 tetor 2019, përkon gjithashtu brenda periudhës zgjedhore të përcaktuar nga neni 8 i Kodit Zgjedhor ku citohet shprehimisht se; *“Zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin apo për njësitë e qeverisjes vendore zhvillohen njëherësh në të gjithë territorin e vendit brenda periudhës që shtrihet nga 15 marsi deri më 30 qershor ose nga 15 shtatori deri më 30 nëntor”*.

Së dyti, nëpërmjet caktimit të datës së re të zgjedhjeve më 13 tetor 2019, krijohet mundësia që me zhvillimin e zgjedhjeve të lira, të ndershme dhe demokratike, Shqipëria të vlerësohet pozitivisht nga vendet anëtare të Bashkimit Europian, duke patur kështu një shans më shumë për të garantuar vazhdimësinë e pandalshme të procesit të integritetit europian të Shqipërisë dhe mosshkëputjes së saj në këtë proces nga Republika e Maqedonisë së Veriut në momentin e çeljes së negociatave të anëtarësimit.

Këshilli i Bashkimit Europian do të vendosë gjatë takimit të 17-18 tetor për çeljen ose jo të negociatave të anëtarësimit për Shqipërinë dhe RMV .

Presidenti i Republikës vlerëson se duke zgjedhur datën 13 tetor 2019 si ditën më të shpejtë për të garantuar zgjedhje gjithëpërfshirëse, Republika e Shqipërisë ka shansin të japë një mesazh inkurajues për një vendim pozitiv të Këshillit.

Është e domosdoshme që të gjitha palët të punojnë bashkërisht drejt këtij objekti që gëzon mbështetjen e plotë të të gjithë popullit shqiptar.

Së treti, data e re e zhvillimit të zgjedhjeve 13 tetor 2019 është në përputhje me periodicitetin kushtetues të zhvillimit të zgjedhjeve për pushtetin vendor dhe nuk cënon vazhdimësinë e ushtrimit të mandateve nga organet aktuale të organeve të qeverisjes vendore.

Periodiciteti i zhvillimit të zgjedhjeve për pushtetin vendor është një aspekt i rëndësishëm i tyre. Referuar parashikimeve të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dita e zhvillimit të zgjedhjeve për pushtetin vendor, nga pikëpamja kushtetuese, mund të tejkalojë mandatin e organeve përfaqësues apo ekzekutiv të njësisë së qeverisjes vendore.

Ka një dallim thelbësor kushtetues midis rregullave për mbarimin e mandatit të organeve të qeverisjes vendore dhe rregullave për mbarimin e mandatit të Kuvendit. Kushtetuta në nenin 65 pika 1 dhe 2 ka përcaktuar në detaje rregullat mbi fillimin dhe mbarimin e mandatit të Kuvendit dhe afatet për realizimin e zgjedhjeve pasuese.

Konkretisht në nenin 65 të Kushtetutës, përcaktohet se:

“1.Kuvendi zgjidhet çdo 4 vjet. Mandati i Kuvendit fillon me mbledhjen e parë të tij pas zgjedhjeve dhe përfundon në të njëjtën datë të të njëjtit muaj të vitit të katërt nga data e mbledhjes së parë.Në çdo rast, Kuvendi qëndron në detyrë deri në mbledhjen e parë të Kuvendit të ri të zgjedhur.

2. Zgjedhjet për Kuvendin e ri zhvillohen në periudhën zgjedhore më të afërt që i paraprin datës së përfundimit të mandatit të Kuvendit. Periudhat zgjedhore dhe rregullat për thirrjen e zgjedhjeve për Kuvendin përcaktohen në ligjin për zgjedhjet.

Një rregull i tillë, me kaq detaje mungon në nenin 109 të Kushtetutës, ku parashikohet zgjedhja dhe mandati i organeve të njësisë të qeverisjes vendore.

Neni 109 i Kushtetutës nuk parashikon momentin se kur fillon apo kur mbaron mandati i të zgjedhurve vendor. Në pikën 1 dhe 2 të nenit 109 të Kushtetutës, parashikohet shprehimisht se:

“1. Organet përfaqësuese të njësisë bazë të qeverisjes vendore janë këshillat, të cilët zgjidhen çdo katër vjet me zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë.

2. Organi ekzekutiv i bashkisë ose i komunës është kryetari, i cili zgjidhet drejtpërdrejt nga populli në mënyrën e parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni.”.

Kjo diferencë midis dy dispozitave kushtetuese (neni 65 dhe 109 i kushtetutës) nuk është një harresë e kushtetutëbërësit, por lidhet drejtpërdrejt me modelin zgjedhor që aplikohet për zgjedhjen e organit ekzekutiv të njësisë së qeverisjes vendore.

Për ilustrim, në kushtet kur për shkaqe të ndryshme, brenda afatit të parashikuar nga ligji, në një njësi të caktuar vendore, nuk do të regjistrohej për kandidim asnjë kandidat, atëherë zgjedhjet

për atë njësi vendore, do të shtyheshin në një datë tjetër, përtej mandatit dhe periudhës zgjedhore të përcaktuar nga Kodi Zgjedhor.

Kjo situatë ekstreme nuk është e përjashtuar nga pikëpamja kushtetuese, dhe siç është sqaruar më sipër kjo ka ndodhur edhe më herët në Shqipëri. Pra, precedenti ekziston.

Ndërkohë neni 109 i Kushtetutës, nuk parashikon as momentin se kur fillon dhe as kur mbaron mandati i të zgjedhurve të pushtetit vendor, apo kur fillon dhe kur mbaron ushtrimi i mandateve prej tyre. Këto çështje rregullohen nga këto akte ligjore :

- Nga Kodi Zgjedhor për efekt të nisjes së procedurave për caktimin e datës së zgjedhjeve për organin pasardhës vendor;

Dhe

- Nga ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, përsa i takon momentit të saktë të fillimit dhe mbarimit të ushtrimit të mandatit nga këshillat dhe kryetarët e bashkive në funksion të parimit të vazhdimisë së funksionimit institucional.

Në nenin 10, pika 1 dhe 2 të Kodit Zgjedhor, përcaktohet qartësisht se:

Neni 10

Caktimi i datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore

1. Data e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore caktohet me dekret nga Presidenti i Republikës. Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, Presidenti zbaton rregullat e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të nenit 9 të këtij Kodi.

2.Për efekt të këtij Kodi, mandati i organeve të qeverisjes vendore mbaron në të njëjtën datë të njëjtit muaj të vitit të katërt pas datës së shpalljes me vendim të KQZ-së në shkallë vendi të rezultateve të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Pra në pikën 2 të këtij neni që përcakton procedurën e caktimit të datës së zgjedhjeve për pushtetin vendor, nuk parashikohet momenti i fillimit të ushtrimit të mandatit, por bëhet e qartë vetëm momenti i mbarimit të mandatit të organeve të qeverisjes vendore, dhe kjo vetëm për efekt të përlllogaritjes së afateve për nisjen e procedurave për caktimin e datës së re të zgjedhjeve me Dekret nga Presidenti, procedurë e cila nis jo më vonë se 9 muaj para mbarimit, sipas kodit zgjedhor të mandatit të organeve të qeverisjes vendore.

Në zbatim të nenit 10/2 të Kodit Zgjedhor dhe duke iu referuar Vendimit nr. 965, datë 10.08.2015, të KQZ-së që ka shpallur rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore në vitin 2015, Presidenti me Dekret nr.10928, datë 05.11.2018, përcaktoi datën 30 qershor 2019, si ditë e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Kjo dispozitë (neni 10 i Kodit Zgjedhor) nuk parashikon dhe nuk rregullon në asnjë paragraf të tij momentin se kur organet aktuale të pushtetit vendor pushojnë së ekzistuari, apo pushojnë së ushtruari mandatet aktuale të tyre.

Kodi Zgjedhor është ligji nëpërmjet të cilit përcaktohet procedura e zgjedhjes së këtyre organeve, dhe jo mënyra se si këto organe organizohen, funksionojnë dhe fillojnë, apo përfundojnë ushtrimin e mandatit të tyre.

Mënyra e organizimit, funksionimit, fillimit dhe përfundimit të ushtrimit të mandatit nga organet e qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, rregullohet në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Në çdo ligj funksional në Republikën e Shqipërisë, përfshi këtu dhe ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, garantohet zbatimi i parimit të vazhdimësisë së funksionimit të organeve publike, sidomos në periudhat tranzitore të transferimit të pushtetit nga organi i vjetër në detyrë të cilit i përfundon mandati, tek organi i ri i zgjedhur sipas ligjit.

Konkretisht në nenin 53, pika 1 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, parashikohet qartë se; *“Këshilli bashkiak ushtron funksionet e tij nga data e konstituimit, sipas nenit 48, të këtij ligji, deri në krijimin e këshillit të ri pasardhës.”*

Të njëjtin vullnet ka parashikuar ligjvënësi edhe për funksionimin e Kryetarit të Bashkisë në këto momente tranzitore.

Konkretisht në nenin 60, pika 4 e ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, parashikohet se: *“4. Ushtrimi i mandatit të kryetarit të bashkisë fillon në çastin kur bën betimin dhe përfundon kur bën betimin kryetari pasardhës”.*

Referuar këtyre dy dispozitave rezulton se Kuvendi i Shqipërisë e ka parashikuar me ligj momentin se kur fillon dhe kur përfundon ushtrimi i mandatit nga organet e qeverisjes vendore.

Në këtë mënyrë nuk krijohet asnjë vakum funksional në organet aktuale të qeverisjes vendore, deri në zgjedhjen dhe fillimin e ushtrimit të mandatit të të zgjedhurve nga zgjedhjet e 13 tetorit 2019.

Çdo pretendim se Presidenti po shkel Kushtetutën, se ai po zgjat në mënyrë të paligjshme ushtrimin e mandatit të organeve aktuale të qeverisjes vendore dhe se qytetarët mbeten pa shërbime, pas datës 10 gusht 2019, nuk qëndron dhe është i pabazuar në ligj.

Qytetarëve shqiptarë u sigurohet me ligj vazhdimësia në ofrimin e shërbimeve nga njësitë e qeverisjes vendore.

Me anulimin e mbajtjes së zgjedhjeve më datë 30 qershor 2019 dhe shtyrjen e zhvillimit të tyre në datë 13 tetor 2019, Presidenti nuk zgjeron aspak mandatin e organeve aktuale të pushtetit vendor, pasi garantimi i parimit të vazhdimësisë funksionale dhe momenti i fillimit dhe përfundimit të ushtrimit të mandatit prej tyre parashikohet nga neni 53, pika 1 dhe neni 60, pika 4 e ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Kjo nuk është një zgjatje e mandatit të organeve të qeverisjes vendore që bëhet nga Presidenti i Republikës, por një vijim i ushtrimit të funksionit prej tyre për një periudhë maksimalisht 3-mujore, si një mundësi që buron nga peridiociteti kushtetues i zgjedhjeve për pushtetin vendor dhe që parashikohet nga ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Në kushtet aktuale, kjo periudhë tranzitore bëhet prezente për shkak të krizës së thellë në vend dhe pamundësisë aktuale të zgjidhjes së saj me marrëveshje midis palëve politike, përveç se, me ndërhyrjen e Presidentit të Republikës për shtyrjen e datës së zhvillimit të zgjedhjeve në periudhën e ardhshme zgjedhore, respektivisht në datë 13 tetor 2019.

Gjithsesi kjo gjendje është brenda frymës së parashikimit kushtetues të nenit 109 që trajton periodicitetin zgjedhor vendor. Në këtë dispozitë të kushtetutës parashikohet se, organet përfaqësuese dhe ekzekutive të njësisë të qeverisjes vendore janë këshillat dhe kryetarët, të cilët zgjidhen çdo katër vjet me zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë.

Rrjedhimisht nisur nga fakti që zgjedhjet paraardhëse të pushtetit vendor janë përmbyllur me rezultatin final në gusht 2015, zhvillimi i tyre në 13 tetor 2019 nuk cënon parimin kushtetues të periodicitetit të zhvillimit të tyre.

XXIV. KONKLUSIONE

Në kushtet e një krize të rëndë të paprecedentë politike, kushtetuese, institucionale dhe përfaqësimi ku:

1. Palët politike u vendosën në një kurs konstant përplasjeje dhe refuzuan dialogun;
2. Opozita hoqi dorë në bllok nga mandatet parlamentare. **182 deputetë dhe kandidatë për deputetë** të opozitës u dorëhoqën dhe refuzuan në bllok mandatet parlamentare.
3. Opozita parlamentare aktuale përftoi mandatet në shkelje të Kodit Zgjedhor dhe procedurave legjislative;
4. Parlamenti nuk u plotësua me numrin kushtetues të 140 deputetëve për shkak të shterimit të listave të kandidatëve nga partitë e opozitës;
5. Parlamenti humbi rolin mbikqyrës ndaj ekzekutivit;
6. Parlamenti dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve refuzojnë njohjen e autoritetit kushtetues të Presidentit të Republikës;
7. Gjykata Kushtetuese është jo funksionale prej 18 muajsh;
8. Gjykata e Lartë është jo funksionale;
9. Prokurori i Përgjithshëm i Përkohshëm u zgjodh në mënyrë të njëanshme antikushtetuese;
10. Prokuroria nuk veproi për zbardhjen e krimeve zgjedhore të konsumuara në vitet 2016 - 2017 – Dosjet 184 (Bashkia Dibër) dhe 339 (Bashkia Durrës);
11. Opozita refuzoi regjistrimin si konkurrent zgjedhor për zgjedhjet lokale;
12. Mazhoranca këmbënguli të garonte e vetme për të marrë në administrim të 61 bashkitë e vendit dhe këshillat e tyre;
13. Zhvillimi i protestave periodike kombëtare të shoqëruara me akte dhune dhe vandalizmi si dhe reagim shproporcional nga forcat e rendit, me pasojë plagosje të shumta nga policia e shtetit dhe qytetarët;
14. Përdorimi i gjuhës armiqësore dhe thellimi i ndasive çoi në rritjen e frustrimit shoqëror dhe emigracionin masiv;
15. Rritja e pasigurisë ndikoi në ekonominë e vendit.
16. Refuzimi i Kryeministrit për të pranuar ndërmjetësim për zgjidhjen e krizës e në vecanti përcaktimin e një date të re gjithëpërfshirëse përveç 30 qershorit;

Presidenti i Republikës vlerësoi se duhet të ndërhynte në mënyrë të tillë që t'u ofronte palëve kohë për reflektim dhe për gjetjen e një zgjidhjeje përmes dialogut të pazëvendësueshëm politik, duke siguruar njëkohësisht mosçënimin e parimeve kushtetuese të pluralizmit politik dhe kthimin e paqes sociale në vend.

Mungesa e plotë e vullnetit politik për marrëveshje midis forcave politike nuk mundet të dobësojë dhe as të kufizojë rolin që Kushtetuta i ka dhënë Kreut të Shtetit. Përkundrazi, ky rol është thelbësor për zgjidhjen e krizave të rënda si kjo që po kalon vendi.

Në këto kushte, Presidenti i Republikës është i vetmi institucion kushtetues funksional që ka vullnetin, mundësinë dhe kompetencën ekskluzive kushtetuese për të ndikuar në kapërcimin e krizës.

Presidenti i Republikës në një Republikë Parlamentare është një organ kushtetues që mishëron unitetin e popullit me rol substancial në procese me rëndësi për rendin kushtetues.

Presidenti i Republikës sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë qëndron mbi të gjitha pushtetet dhe nuk bën pjesë tek ato.

Pikërisht ky rol i jep Presidentit të Republikës të drejtën që të ndërhyjë, me mjetet në dispozicion, në situata krizash të rënda me qëllim zgjidhjen e tyre.

Veçanërisht në mungesë të institucioneve që mund të zgjidhin konfliktet kushtetuese apo që mund t'i jepnin përgjigje shumë kërtimeve të kësaj natyre, roli i Presidentit të Republikës është primar dhe i pazëvendësueshëm, pasi është i vetmi organ kushtetues që e ka mundësinë kushtetuese të ndërhyjë me mjetin që ai disponon.

Kreu i Shtetit me Dekretin nr. 11199, datë 10.06.2019 ndërpreu ligjërisht një proces zgjedhor fiktiv që po zhvillohej në kundërshtim me parimet demokratike. Praktikisht ky ishte një proces votimi pa garë dhe pa alternativa, në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me standartet e OSBE/ODIHR, nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNj, si dhe detyrimet e MSA Shqipëri-BE.

Njëkohësisht, antagonizmi politik shtyu palët drejt veprimeve ekstreme duke kërcënuar seriozisht sigurinë publike.

Dekreti 11199 është në fuqi për sa kohë asnjë autoritet gjyqësor nuk ka urdhëruar shfuqizimin e tij. Bashkë me Dekretin nr. 11211, për caktimin e datës 13 tetor 2019 për organizimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, Presidenti i Republikës përmbyll një proces tërësisht kushtetues.

E drejta e Presidentit të Republikës për të caktuar datën e zgjedhjeve sipas nenit 92/gj të Kushtetutës nuk mund të kuptohet dhe as të zbatohet më vehte, pasi kjo dispozitë kushtetuese është e lidhur ngushtësisht me dispozitat e tjera të kushtetutës nenit 1/3, 3, 4, 5, 15, 45/1 e 4, 86/1, 93, 109 të Kushtetutës që parashikojnë parimet themelore, të drejta dhe detyrime, të cilat duhet domosdoshmërisht të respektohen përgjatë një procesi zgjedhor në një shoqëri demokratike.

Të gjitha së bashku këto dispozita formojnë një entitet normash kushtetuese në përmbushje të të cilit Presidenti i Republikës duhet të veprojë për përmbushjen e një qëllimi kushtetues e të ligjshëm që është shmangia e çdo mundësie për trazira sociale në vend, garantimin e pluralizmit politik dhe përcaktimi i një date të re zgjedhjesh vendore në mënyrë që ato të zhvillohen në një situatë të qetë, të lira dhe demokratike në mënyrë që të gjithë qytetarëve të Republikës së Shqipërisë pa dallim t'u krijohet mundësia për të zgjedhur midis alternativave.

Po kështu, mbrojtja dhe përparimi i interesave të përbashkëta kombëtare është një nga detyrat kryesore të Presidentit. Pas anëtarësimit në NATO, të realizuar një dekadë më parë, anëtarësimi në BE është objektivi strategjik kombëtar i vendit, shoqërisë dhe gjithë forcave politike.

E gjithë sjellja e Presidentit të Republikës dhe përpjekjet e tij, duke qenë shumë i ndërgjegjshëm dhe për detyrimet që duhen përmbushur veçanërisht për çeljen e negociatave të anëtarësimit me BE, kanë synuar shmangien e një konflikti civil, të një procesi të dështuar zgjedhor dhe realizimin e zgjedhjeve vendore gjithëpërfshirëse dhe demokratike për të përmirësuar besueshmërinë e vendit në përmbushjen e kritereve politike në prag të 17-18 tetorit 2019, kur do të merret vendimi i Këshillit European për Shqipërinë.

XXV. Gjetjet kryesore të raportit përfundimtar të Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve (EOM) të ODIHR/OSBE për votimet të dt. 30.06.2019

- Zgjedhjet lokale të 30 qershorit u mbajtën me pak konsideratë për interesat e zgjedhësve.
- Në klimën e një bllokimi politik dhe polarizimi, votuesit nuk kishin mundësi zgjedhjeje thelbësore midis alternativave politike. Në 31 nga 61 bashkitë kandidatët për kryetarë garuan pa kundërshtarë.
- Kriza politike u intensifikua me afrimin e ditës së zgjedhjeve. Shumë aktorë të interesuar vendas dhe partnerë ndërkombëtarë në Shqipëri bënë thirrje për dialog për të zgjidhur krizën politike, por partitë politike treguan në përgjithësi pak vullnet për t'u angazhuar në një bashkëpunim konstruktiv.
- Ky antagonizëm ishte tregues i mungesës së përgjegjësisë së përbashkët ndaj integritetit të procesit zgjedhor që duhet të tejkalonte ndasitë partiake, dhe, rrjedhimisht, ndikoi negativisht në të drejtën e qytetarëve për të marrë pjesë në qeverisje.
- Atmosfera e pasigurisë ligjore dhe ngërçi i krijuar në marrëdhëniet ndërmjet institucioneve kryesore minoi besimin e publikut për legjitimitetin e zgjedhjeve.
- Përballja politike çoi në pasiguri ligjore dhe shumë vendime të administratës zgjedhore u morën me objektivin politik për të siguruar zhvillimin e zgjedhjeve.
- Më 10 qershor, Presidenti Meta lëshoi një dekret që anulonte zgjedhjet duke përmendur shqetësime për sigurinë publike dhe përgjegjësinë e tij kushtetuese për të mbrojtur pluralizmin. Presidenti i Republikës anuloi zgjedhjet e 30 Qershorit nisur nga nevoja për të garantuar sigurinë publike dhe përgjegjësia e tij kushtetuese për të mbrojtur pluralizimin politik. Dekreti i Presidentit të Republikës për caktimin e datës 13 Tetor si ditë të zgjedhjeve lokale nuk u publikua në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, edhe pse publikimi i këtij akti të Presidentit të Republikës është i detyrueshëm nga ligji.
- Vetëm Gjykata Kushtetuese është e autorizuar të gjykojë mbi kushtetueshmërinë e dekreteve të Presidentit të Republikës.
- Pasiguria u rrit më tej nga mosmarrëveshja midis palëve të interesuara zgjedhore në lidhje me ndarjen e përgjegjësisë midis Gjykatës Kushtetuese, si organi i vetëm i mandatar për të vendosur mbi kushtetutshmërinë e dekreteve presidenciale, dhe Kolegjit Zgjedhor që ka mandat të mbikëqyrë ligjshmërinë e procesit zgjedhor.
- Mospranimi i komisionerëve të opozitës në administratën zgjedhore për shkak të interpretimit të ligjit nga KQZ, e la administratën zgjedhore politikisht të

zhbalancuar. Për pasojë, shumë bashkëbisedues të Misionit të Vëzhgimit të ODIHR shprehën mungesë besimi për të gjitha nivelet e komisioneve.

- Shumë interlokutorë të EOM përgjatë gjithë spektrit politik besonin se një marrëveshje ndërmjet partive është e nevojshme për të parandaluar humbjen e mëtejshme të besimit ndaj demokracisë, zgjedhjeve dhe politikanëve.
- Në disa raste KQZ zbatoi ligjin në mënyrë të paqëndrueshme ose në mënyrë të njëanshme. Disa vendime të KQZ-së, përfshirë ato për mosregjistrimin e kandidatëve dhe ankesave, u publikuan me vonesë të konsiderueshme, duke cënuar transparencën.
- Vendimit për refuzimin e komisionerëve të opozitës KQZ i dha karakterin e një vendimi normativ, që sipas Kodit Zgjedhor dhe standardeve zgjedhore të Komisionit të Venecias, kërkon shumicë të cilësuar, ndërkohë që ai u miratua me shumicë të thjeshtë votash.
- Disa bashkëbisedues të ODIHR pohuan se komisionerët e emëruar kryesisht nga KQZ, që duhet të ishin ekspertë të pavarur, në fakt ishin pa përvojën e duhur ose në të vërtetë ishin përfaqësues të PS.
- KQZ e interpretoi ligjin në një mënyrë tepër të gjerë dhe ndonjëherë në mënyrë kontradiktore, duke cënuar sigurinë juridike. KQZ regjistroi Partinë Bindja Demokratike (PBD) si subjekt zgjedhor më 27 prill, megjithëse kjo e fundit u regjistrua si parti politike vetëm më 25 prill, me një vendim gjykatë që mori formë të prerë më 10 maj. KQZ nuk kërkoj që PBD e regjistruar rishtaz të mbledhë nënshkrime mbështetëse.
- Duke iu referuar rastit të kërkesës së Partisë së Uniteti Kombëtar për t'u tërhequr nga zgjedhjet, dhe vendimeve përkatëse të Kolegjit Zgjedhor dhe KQZ, u vërejtën me shqetësim: i) mungesa e paanshmërisë së KQZ dhe votimi i anëtarëve të saj mbi linja partiake; ii) fakti që gjykatësit e Kolegjit Zgjedhor janë subjekt i procesit të vetingut, që mund të ndikojë sigurinë e mandatit të tyre dhe potencialisht pavarësinë e tyre në vendimmarrje.
- Qytetarët, veçanërisht ata të punësuar në administratën publike, u vunë nën presion për të demonstruar një preferencë politike, çka është në kundërshtim me Paragrafin 7.7 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së 1990.
- ODIHR EOM mori shqetësime nga qytetarët se rezultati i votës ose abstenimi do t'i ekspozonte ata ndaj ndëshkimit në komunitetet e tyre. Disa përshkruan kërcënime të drejtpërdrejta, si kërcënime për pushimin nga puna ose tërheqjen e përfitimeve të shërbimeve sociale. ODIHR EOM mori shumë pretendime që me gjithë ndalesat ekzistuese në kuadrin ligjor dhe masat e reja të paraqitura në maj, punonjësit e administratës publike dhe ndërmarrjeve publike ishin nën presion të drejtpërdrejtë dhe tërthortë për t'u përfshirë në veprimtari politike gjatë dhe pas orarit të punës. ODIHR

EOM konstatoi pjesëmarrjen e zyrtarëve lokalë, shërbimeve shëndetësore dhe stafin pedagogjik në mitingje të mëdha të udhëhequra nga PS, që në shumë qytete u mbajtën menjëherë pas orarit të punës. Të marra sëbashku, këto janë në kundërshtim me Paragrafin 5.4 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së 1990.

- Praktika e përdorur nga PS dhe zyrtarët e saj për ta furnizuar ata median me pamjet nga aktivitetet zyrtare dhe fushata, ndërkohë që kufizuan qasjen e tyre në to, kufizuan aftësinë e votuesve për të marrë informacion objektiv.
- ODIHR ishte dëshmitar i rasteve të kërcënimit të votuesve dhe shkeljes së fshehtësisë së votës në qendrat e votimit, mirëpo për këto raste nuk është regjistruar zyrtarisht asnjë procedim penal nga prokuroria. Ka një shqetësim për mungesën e përgjithshme të efikasitetit të hetimeve penale që kontribuojnë në thellimin e perceptimit të pandëshkueshmërisë mbi krimet zgjedhore të kaluara, duke përfshirë blerjen e votës dhe presionin ndaj votuesve.

• **A N E K S–**

- 1. Raporti i OSBE/ODIHR mbi zgjedhjet**
- 2. Historiku i denoncimit të aferës korruptive për projektin infrastrukturor në “Unazën e Re”.**
- 3. Informacion mbi publikimin në të përditshmen gjermane “Bild” të materialeve nga dosjet penale 184 dhe 339.**
- 4. Historiku i zbatimit të njëanshëm të reformës në drejtësi dhe pasojat e krijuara.**
- 5. Argumentat ligjore të paligjshmërisë së procesit të dorëheqjes dhe zëvendësimit të mandateve nga Kuvendi dhe KQZ.**
- 6. Qëndrimet e Presidentit të Republikës për vendosjen e dialogut politik.**
- 7. Reagimet e aktorëve vendas dhe ndërkombëtarë mbi përshkallëzimin e krizës në Shqipëri.**
- 8. Dekreti nr. 11199, datë 10.06.2019 dhe arsyetimi përkatës.**
- 9. Vendimi i KQZ nr. 836, Datë 13.06.2019, ora 12:00.**
- 10. Fleta e rezultatit të votimit të Rezolutës së Kuvendit dt. 13.06.2019, ora 16:08.**
- 11. Historiku i rasteve të shtyrjes së zgjedhjeve në Shqipëri.**
- 12. Letra e SHBA dhe BE drejtuar ish-Kryeministrit të RMV.**